

NJË VIT ExLibris

PËRSE E BOTOJ KËTË GAZETË

nga
Bujar Hudhri

**SOT DHE NESËR
DY DITË E FUNDIT
TË PANAIRIT TË
LIBRIT.
JU MIRËPRESIM**

Roland Gjoza


LETËRSIA ËSHTË
SHËN LLAZARI I
FASHUAR. VDES
DHE NGJALLET
PËRSËRI.



f. 3-4

Intervistë me Xhevair Lleshin

Portreti nga Ina Lajthia



IN MEMORIAM: regjisorja Arzana Kraja

nga Sadik Bejko

f. 2

PROZA E TË MALLKUARIT

NGA

ISMAIL KADARE



f. 6

Fjalori frazeologjik anglisht-shqip, i Prof.
Dr.Eshref Ymerit, një Monument në Fondin
e Artë të Kulturës kombëtare

f. 10

Kur këndonin gjelat e tretë

tregime nga

**Agron
Tufa**

BIBLIOTEKË



VJEDHJA E ZJARRIT

ese nga
**Rexhep
Ferri**



Kryqi i Diktatorit

nga Shpëtim Doda

f. 12



Letrat më
famëkeqe të
refuzimit për
botimin e
librave

f. 14

Toby Faber

PËRSE E BOTOJ KËTË GAZETË

nga Bujar Hudhri

Ka qenë fillimi i vitit 1988, kur nisa punën në redaksinë e një gazete lokale, që dilte çdo të mërkurë dhe të shtunë. Ndonëse nuk kishim një ndarje sektorësh, mua më lanë hapësirën për krijimtarinë letrare artistike. Me sa dukej ishte një orientim nga lart, që shtypi të afrohej më shumë me lexuesin dhe në gazetë vërshuan shumë krijues, sidomos të rinj. Nisën të vinin edhe në redaksi, por pas një kohe të shkurtër, kjo u duk si e tepërt nga kryeredaktori. Edhe ciklet me poezi që përgatisja, me vështirësi e gjenin rrugën e botimit. Më ka ngelur në mendje një nga këto cikle, kur një poet i njohur i qytetit kishte përfshirë edhe një poezi për lejlekët, për trishtimin që po linin pas shtegtimt. Kur ia paraqita kryeredaktorit, ai më pa me një lloj habie dhe tha: po ç'janë këto lejlekë në gazetën tonë. S'është serioze! Dhe nuk u botua atë numër. As në tjetrin, tjetrin, me radhë. Kur një ditë prej ditësh, kishte ngelur një vend bosh dhe kryeredaktori i shqetësuar se po afronte koha e shtypit, më kërkoi një shkrim të shkurtër unë gjeta rastin t'i kujtoja poezinë e lejlekut. Më pa me njëfarë dhembshurie sikur të më thoshte të dija më serioz.

Në shtator të vitit 1991 themelova një gazetë me titullin 'Fjala e lirë'. Tani isha vetë zot dhe askush nuk më pengonte të botoja ç'të doja. Por tashmë ishte tjetër kohë. Lexuesi kërkonte tjetër gjë, letërsia shqipe nuk kishte më aq lexues, krijuesit mund të botonin në shumë organe letrare që u themeluan. Ka qenë një kohë vërtet idealiste kur vendi po ndahej nga një periudhë pesëdhjetëvjeçare dhe gazetë politike ishin më të kërkuarat. Si botues gazete edhe unë nuk bëra përjashtim deri sa mbaruan edhe zgjedhjet e para lokale të vitit 1992. Kisha menduar që ta orientoja gazetën drejt letërsisë, por kjo u duk që ishte e parakohshme.



Lexuesit donin sa më shumë politikë, ndërsa unë synoja botimin e krijimtarisë letrare. Një gazetë e tillë s'mund të kishte jetë të gjatë atë kohë. Dhe u gjend zgjidhja. Kishte ardhur momenti që të botoja jo një poezi apo dy, por libra të tërë dhe këtë mund ta arrija me themelimin e një shtëpie botuese. Po atë vit themelova Onufrin dhe i kam ndenjur besnik, sidomos letërsisë shqipe, duke botuar majat e saj Kadare e Camaj si edhe një listë të gjatë shkrimtarësh, nga më të talentuarit e letrave shqipe, këndej dhe andej kufirit.

E megjithatë, refuzimi i ish-shefit tim për të mos botuar atë poezi të bukur për shtegtimin e lejlekëve, më ka ngelur në mendje sot e gjithë ditën. Madje, mund të them kjo ka qenë përherë një shtysë e fortë për të hapur një gazetë letrare. Kam tentuar disa herë që ta hap këtë gazetë (emri nuk ka ndryshuar, pavarësisht viteve) më 1996, pastaj më 2006, herë tjetër më 2014 derisa e themelova më 16 nëntor 2018, sepse kisha një lajm që vetëm unë e dija dhe ky ishte botimi i librit të fundit të Kadaresë "Kur sunduesit grinden". Ishte si një bekim.

Tani kjo gazetë ka mbushur një vit. Ndryshe nga ç'mund të hamendësohej, kurrë nuk kam pasur si synim të botoj një gazetë vetëm për librat e autorëve të mi. Kanë dalë deri më tani 52 numra dhe cilido mund ta shfletojë online apo ta blejë në kioskat e gazetave dhe ta konstatojë këto që po shkruaj.

Në këtë përvjetor të parë, gjej rastin edhe një herë t'i ftoj kolegët e mi të bashkëpunojnë me këtë gazetë, po ashtu krijuesit dhe studiuesit e letërsisë shqipe kudo që ndodhen, si dhe përkthyesit për të përcjellë zhvillimet e fundit të letrave botërore.

Në fund dua t'i shpreh mirënjohjen për kontributin e saj kryeredaktore së parë, gazetares së mirënjohur Violeta Murati.

IN MEMORIAM: regjisorja Arzana Kraja!

nga Sadik Bejko

Ka vdekur Arzana Kraja, regjisore, bija e shkrimtarit Mehmet Kraja, Kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Kjo ngjarje është shumë e hidhur për botën e kinematografisë në Kosovë, botë ku Arzana Kraja ka kontribuar.

Është e hidhur dhe për rrethet e shkrimtarëve dhe të akademikëve të Kosovës, rrethe ku emri i Mehmet Krajës është një nga më të përmendurit, nga më të çmuarit.

Kjo ngjarje më prek dhe mua personalisht.

Si një i njohur i familjes Kraja, si bashkëpjesëmarrës dhe përcjellës me shkrimtarin dhe akademikun Mehmet Kraja i shumë veprimtarive kulturore në Tiranë Shkup, Prishtinë, Ulqin, si një nga lexuesit dhe vlerësuesit e veprimtarisë prej shkrimtari eseisti e veprimtari të Mehmet Krajës, unë sot ndjem në helm zisë që i ka rënë në pjesë asaj familjeje. Familjes së mikut, kolegut tim.

Kjo është ngjarje e hidhur dhe për rrethet e krijuesve, të botuesve, të akademikëve e të publicistëve të Tiranës, rrethe ku Mehmet Kraja ka lënë gjurmë të pashlyera si krijues me integritet, si hartues veprash me cilësi të shënuara artistike

I shpreh ngushëllime familjes së Mehmet Krajës.


Arzana Kraja u prehtë në paqe dhe në mirësi.

Të bëjnë durim në zemër dhe në mendje ata që e rritën dhe e deshën Arzanën.

Të bëjnë kurajo për ta përqafuar çdo ditë jetën.

Kështu Arzana do të jetë e gjallë.

Sa kohë ata që e deshën, do të rrojnë dhe do ta kujtojnë atë, për aq kohë Arzana do të jetë e gjallë.



Roland Gjoza

LETËRSIA ËSHTË SHËN LLAZARI I FASHUAR. VDES DHE NGJALLET PËRSËRI.

Intervistë me Xhevair Lleshin

Xhevair Lleshi - Roland, ç'të porosis për ty?

Roland Gjoza - Nje kafe ekspres të gjatë.

XH. LL. - Tjetër?

R. GJ. - Asgjë.

XH. LL. - Ndonjë pije?

R. GJ. - Jo.

XH. LL. - Marlboro të bardhë?

R. GJ. - Jo, nuk pi cigare. Mos u çudisni, nuk kam nevojë për asnjë lloj eksitanti që të sjell në qejf e të nxit të shkruash. Ato janë të mira, unë i pëlqej, po nuk m'i pranon ky djall organizmi.

XH. LL. - Dobësi?

R. GJ. - Në shikim të parë ashtu duket, humbet ca raste të mira drekash e darkash me miq, provon një ndjenjë vetëpërrjashtimi, je si në bisht të syrit, jo përballë. Edhe pa pirë jam si i pirë. Mund të shkruaj në çdo rrethanë, po këtë nuk e bëj. E respektoj shumë aktin e të shkruarit, i cili kërkon momentin e duhur dhe shumë vetmi.

XH. LL. - Ç'është kjo vetmi e të shkruarit?

R. GJ. - Shkrimtari lind, nuk bëhet. Atë e shoqëron vetmia që në lindje. Ai ka një dhembshuri në përgjithësi për njerëzit, siç thotë Çehovi. Tryeza e shkrimit me takëmet; lapsi, stilolapsi, goma, letra, është fabrika e tij. Sot përdoret kompjuteri, por jo nga të gjithë. Për një sy të huaj procesi i të shkruarit është tejet monoton e i mërziqshëm. Por ai, shkrimtari, arrin të prodhojë në këto orë vetmie, për ditë e ditë të tëra, për muaj e vite, nga një mal me libra, një libër të qëlluar, në qoftë se është me fat.

XH. LL. - Pse një libër?

R. GJ. - Për mua aq mbetet. E them në një kuptim simbolik. Shkruhet kaq shumë, ka aq tepër libra, sa, jo rrallë, të vjen të heqësh dorë. Sa mirë do të ishte që shumica të hiqnin dorë. Po kjo nuk ndodh, sepse letërsia është iluzion i pamposhtur. Hiqi njeriut pandehmën se është i madh, dhe ai ka për të të urreyer. Kjo është sindromë e kohës.

XH. LL. - Letërsia është e rrezikshme, sipas jush?

R. GJ. - Shpesh mbetet t'ia pohojmë vetes. Çfarë, do të pyesni ju? Që të heqim dorë. Pastaj të nesërmen pendohe mi. Shkruajmë përsëri. Nuk thashë se letërsia është e rrezikshme. Ajo është dashuri. Është një prodhim që del nga sineriteti dhe e vërteta. Këtë e ka thënë Heminguej. . .

XH. LL. - Është e vështirë të shkruash duke u nisur nga sineriteti dhe e vërteta?

R. GJ. - Është e vetmja mundësi. Është trimëri. Është fat, në qoftë se të ecën. Përvojat janë frutdhënëse, po shpesh të hidhura. Do të thuash atë që është, jo atë që mendon. Botova romanin «Mëkati», që u prit mirë. Është një ngjarje e vërtetë, që ka ndodhur në fëmijërinë time. Personazhet janë prindërit e mi. U nisëm natën në drejtim të një kishe, bëmë shumë rrugë në këmbë. Në atë kohë, familjes sime nuk po i ecte, kërkonim ndihmë nga zoti. Ajo ishte një natë me

shumë sekrete që duheshin mbajtur fshehur, po me një tharm të madh artistik, që më tundonte tmerrësisht. Duhet sakrifikuar privacia e familjes, që e dinin pak vetë, privaci e kaluar nëpërmjet filtrit të sineritetit dhe të së vërtetës, që për rrethin e ngushtë familjar donte të thoshte tradhti, ndërsa për publikun thjesht një vepër letrare e bukur. A do të kisha kurajë për ta bërë? U prisha me hallën, bëra fjalë me babanë, shumë nga farefisi ma hoqën fillin. Kjo mëri vazhdon sot e kësaj dite. Pas një suksesi fshihen shumë sakrifica.

XH. LL. - Letërsia nuk është një trillim?

R. GJ. - Trillimi është, po vjen më vonë, kur realiteti kërkon ndihmë. Nuk ka letërsi pa një nxitje nga jeta dhe pa imagjinatë. Shkrimtarët presin kujtimet e pyllit të tyre familjar. S'mbetet sekret pa nxjerrë. Çehovi u prish me miqtë, Gollsuorthi me farefisin, Tolstoi me familjen, Kadare pati punë me pinjojtë e familjeve të fisme gjirokastrite dhe plot raste shkrimtarësh të tjerë.

XH. LL. - Jo të gjithë sakrifikojnë, apo jo?


R. GJ. - Nuk është këtu thelbi i çështjes, as se për çfarë do të shkruash, po as si do ta shkruash. Është diçka më e thellë. Vepra fle. Fle dhe rritet. Brenda teje. Ajo është e fashuar si Shën Llazar. Është e gjallë. Po dhe e vdekur. Gjallëvdekura, kjo simbioze delikate trondit shkrimtarin gjatë gjithë jetës së tij. Kur e shikoni të hutuar, krejt të shpërqendruar, të zymtë e indiferent, ta dini se ai merret me Shën Llazarin, i heq një nga një fashot. Ky proces i brendshëm mund të zgjasë 20 vjet dhe vepra mund të dalë për dy javë. Kur shkruan, je nën pushtetin e saj te pamposhtur. Mbaroi. As ti s'e di si ndodhi, doli prej teje, apo ti ishte ena që e mbajti dhe fryma e nxori. Është një proces i shenjtë për mua. Për shumë kohë je i pavetëdijshëm, po brenda vetëdijes, je ti dhe s'je ti, je i zgjedhuri, i shënuari për të shqiptuar, për të lënë një kumt.

XH. LL. - Besoni se kumtet kështu kanë ardhur?

R. GJ. - Unë besoj. Kam dhe forcë parashikuese në kohëra të vështira. Vijnë plot sinjale të turbullt që lënë një mbresë, e cila deshifrohet si në shkrimet e shenjta. Shkrimtarët e mëdhenj, aq shumë i afrohen sekreteve divine, sa ata shpesh herë nuk besohen se kanë qene njerëz; Homeri, Dante, Shekspiri. Kjo pandehmë e një fuqie të mbinatyrshme na kaplon sa herë lexojmë veprat e mëdha.

XH. LL. - Shkruhen sot vepra të mëdha?

R. GJ. - Në çdo kohë shkruhen vepra të mëdha. Po ca






kohë janë fatlume, ca të tjera jo dhe aq. Para tre vjetësh po dëgjoja në një emision televiziv, Norman Milerin, me të madhin shkrimtar klasik të gjallë amerikan. Ai e shikonte fundin e letërsisë amerikane në fundin e viteve 60 të shekullit të kaluar. Shkrimtaret më të mëdhenj amerikanë ai cilësonte Heminguejin, Folknerin, Stainbekun. Pas tyre, Miler, nuk shikonte ndonjë shkrimtar tjetër të atij kalibri. Romane shkruhen shumë, po kriteri i bestsellerit i ka sjellë letërsisë një humbje të madhe.

XH.LL. - Bestsellerët nuk kanë vlerë të vërtetë?

R.GJ. - Bestseller do të thotë romane që shiten më shumë. Po të hysh në mollet dhe farmacitë amerikane, pranë veshjeve dhe ushqimeve, do të gjeni një mori romanesh, të gjitha bestseller. Shkrimtaret gra zënë vendin e parë. Ato janë më të lexuarat. Gazeta më e madhe amerikane «The New York Times» shpall çdo javë bestseller. Ato i lexojnë me një frymë. Janë letërsi zbavitëse. Bëhen filma, qe zënë 99% te prodhimeve kinematografike. Njeriu sikur rend të fitojë parà, të sigurojë një shtëpi të mirë, të martohet e të rimartohet disa herë dhe, në atë ndërkohën, kur e zë një molisje kotësie, i hedh sytë një libri që ka brenda horror, seks, dhunë gjer në fund, një grua të bukur që tradhton, një burrë superhero që jep jetën për një qytet apo për një shtet të pushtuar nga horra dhe kriminelë. Në këto romane ka vetëm intrigë policeske si tek i famshmi «Kodi Da Vinci.» Në Shqipëri u shpall bestseller me pohe e bujë romani «Të jetosh në ishull» i Ben Blushit. Ai çdo gjë mund të jetë, po roman s'ma merr mendja. Po mos mendoni që këto romane nuk shkruhen seriozisht. Përkundrazi, romancierët e kësaj letërsie, nuk dinë ku t'i vënë paratë, ata dalin në televizion dhe duan të të mbushin mendjen, se letërsia është një histori e bukur, që duhet të intrigojë e të tërheqë vëmendjen.

XH.LL. - Ju nuk mendoni se letërsia është një histori e bukur?

R.GJ. - Letërsia e vërtetë nuk vlerësohet nga historia e bukur, po nga teksti, shumëkuptimësia, gjuha, stili. Letërsia e bestsellerëve është e rrafshët me një mundësi horizontale leximi, ndërsa letërsia e vërtetë shkon poshtë vertikalisht dhe zbulon habitshëm shumë mundësi leximi, sepse është e pasur me tekst përplot faceta diamanti si të jetë pajisur me shqisë të shtatë, ditë të tetë të javës, dimension të pestë. Një roman të suksesit të madh, që «New York Times» e shpall bestsellerin më të famshëm, mund ta lexosh me një frymë, si një rrëfim linear, pa u ndalur te



domethënia e shumë ngjarjeve, veçanësitë befasuese të gjuhës, origjinaliteti i stilit, sepse s'ka gjëra të tilla. Këta bestseller kaq të bujshëm, harrohen shpejt, janë si kometa në qiellin e letërsisë. Këtu fillon dhe keqkuptimi me lexuesit.

XH.LL. - Pse fillon pikërisht këtu?

R.GJ. - Sepse këtu është vija ndarëse. Shkrimtari i vërtetë, që shpeshherë harrohet, është jashtë vijës së verdhë, ku s'ka lexues, ndërsa shkrimtari i bestsellerëve është brenda vijës së verdhë, ku është lexuesi, sukcesi, paraja. A mendoni se ai që ndjek Portokallinë, apo Big Brather, e që përbën 90% të njerëzve, do të lexonin Frederik Rreshpjen, Luis Borhesin, Franc Kafkën, Xhejms Xhojsin apo Marsel Prustin? Natyrisht që jo. Ç'duhet bërë? Asgjë. Ky është mallkimi. Hyn te sakrifica, te një faqe e sakrificës. Se sakrifica ka shumë faqe. Një nga ato është lexuesi, një tjetër mund të jetë lufta për bukën e gojës, një tjetër, harresa, e kështu me radhë.

XH.LL. - Ju ne ç'faqe jeni?

-- Lufta për bukën e gojës. Shkruaj, se nuk rri dot pa shkruar, po budallallëk është që shkruaj, se nuk kam si e justifikoj. Gazetat nuk paguajnë. Botuesit kërkojnë parà. Libri nuk blihet. Kur botoj një libër heq diëka nga goja e fëmijëve. Po nuk bie në dëshpërim. Shkruaj. Është tejet e dhimbshme dhe e bukur të shkruash. T'ia thuash një njeriu që bën hesape, ai të vë vizë, t'ia thuash gruas, ajo të thotë mjaft se u lodhe, për të fshehur mosbesimin e saj të madh, t'ia thuash nënës, ajo të kopjon, shkruaj, bir, se kushedi ç'bën perëndia, t'ia thuash fëmijëve, ata të thonë, babi, kot e ke, s'të lexojmë...

XH.LL. - Vërtet keni mendimin se nuk ju lexojnë?

R.GJ. - Dy tre, jo më shumë. I them me shaka ndonjë miku, se ka ardhur koha të blejmë lexues...

XH.LL. - Do ta bënit?

R.GJ. - E kam bërë. Gjeta nja dy njerëz të mirë që më lexojnë dhe nga kënaqësia paguaj kafet, ndonjë drekë. Ata më kuptojnë. Janë më të rëndësishëm se unë. Kjo kohë ka ardhur. Kam botuar në Prishtinë disa libra nga shtëpia botuese «Buzuku», po nuk besoj të kem lexues. Ndoshta kjo është dhe një shenjë e keqe, po dhe një shenjë e mirë, ku i dihet?

XH.LL. - S'keni fituar asgjë nga letërsia?

R.GJ. - Në kuptimin e fitimit kam humbur, kurse në atë shoqëror, nuk ndjem vetëm, kur shkoj te mjeku ai habitet, se nuk më gjen përqindje të lartë kolesterolit dhe ndonjë gjendje depresioni për t'u shqetësuar, prej të cilit vuajnë gjysma e amerikanëve, sepse shkrimi është terapi.

XH. LL. - Shkruani, po pse shkruani?

R. GJ. - Për bukën e shpirtit. Shpirti im ka uri të përhershme. Kjo është ana figurative. Po ndoshta shkruaj nga mallkimi që duhet të shkruaj, ose shkruaj ngaqë s'di të bëj gjë tjetër. Sot i mungojnë shumë gjëra një shkrimtari.

XH. LL. - Çfarë, për shembull?

R. GJ. - Habitati, ai sikur s'është në kohën dhe vendin e vet. Nëse ka një njeri fare të tepërt, ai është. Koha. I mungon koha, sepse ai lufton për bukën e gojës. Harresa. Sepse ai s'ka lexues. Pushteti nuk merret me të. Sot është koha e interesit. Ç'interes mund të ketë për një shkrimtar të vetmuar, që s'është as deputet, as anëtar partie? Mjerë ai që është shkrimtar dhe kaq. Lum ai që është shkrimtar dhe kaq.

XH. LL. - Cila duhet besuar më tepër?

R. GJ. - Të dyja.

XH. LL. - Po pse?


R. GJ. - Për mendimin tim i pari nuk thotë më se është shkrimtar, ngaqë i duket pak, ai ka me çfarë të shesë mend, ndërsa i dyti s'e çan fare, ai është eremiti kokëkrisur i shtëpisë me qira.

XH. LL. - Ky eremit me çfarë merret?

R. GJ. - Me zejen më të vjetër në botë, me fjalën. Dhe bën një punë dosido, sa për t'ia hedhur. Këtu në Amerikë shkrimtarët janë shumë të ditur, një pjesë e madhe profesorë universitetesh. Edhe ai, që unë e dua shumë, po që vdiq në një aksident automobilistik, i pirë tapë, ngaqë e donte shume atë të shkretë gotë, Raymond Carver, ishte profesor universiteti. Ai mbahet si Çehovi i tregimit amerikan. I kam përkthyer disa tregime të mrekullueshme dhe kam ndjerë shijen e Heminguejt dhe Sarojanit. Treçerekun e kohës ia kam vjedhur Amerikës për të shkruar romane, tregime dhe poezi. Pse them kështu, sepse në Amerikë është shprehja *Time is money*, pra, koha është parë. Të gjithë nxitojnë për të fituar atë të nxirë para, ndërsa unë primitivi, shkruaj në metro, në punë, në shtëpi. Këtu ka një gazetë që s'lexohet, që i merr shkrimet të gatshme nga interneti dhe mbushet me reklama, ka gjithashtu një lidhje shkrimtarësh pa shkrimtarë dhe shumë kafene. Ka shkrimtarë të mëdhenj që unë s'i njoh. Shoqata pa fund me emra të konsumuar patriotikë, që ju ka ngelur ora te viti 13. Po kjo s'ka asnjë rëndësi për mua, se ua kam pirë lëngun këtyre gjasma prej vërteti, që e kanë mbytur botën shqiptare. Ne kemi marrë me vete provincën dhe e kemi lëshuar në mes të Amerikës. Mungon vetëm ai huri proverbial te qoshku i kafenesë ku lidhej gomari, ndërsa tani parkohet vetura e re që bie shumë në sy.

XH. LL. - Nuk keni botuar asgjë kohët e fundit?

R. GJ. - Tani jam larg. Kur isha atje, atdheu ishte harresa, këtu është kujtesa, një atdhe i dyfishtë dhe në ëndrra. Kaq shumë e kemi dashur? Jo, kurrësi. Ne këtej vuajmë nga sëmundja e mallit, një dreq malli që e sflit dhe *eremitin e shtëpisë me qira*. E kemi për nder të botojmë në atdhe. Është si një lutje e shqiptuar. Si një amanet i përmbushur. Po si për ironi ndodh dhe komedia. Ne vëmë mënjane paratë për qiranë, taksat e kripura dhe harxhet, që s'dalin, për një libër. Sapo hyjmë në marrëdhënie me botuesin, ai shndërrohet



në tregtar dhe ne në myshterinj. Sa kile? Me fal, sa kopje? 300. Kush do t'i tërheqë? Kam një mik që do të vijë t'i marrë. Po të vijë t'i marrë, ama, se nuk kam ku t'i mbaj. Libri ka dalë me shumë gabime shtypi, se nuk ka më korrektore e redaktorë (janë shkurtuar këto vende pune si të panevojshme). Në librari të thonë, kot e keni, vetëm Kadare dhe Agolli blihen... E di ç'kohë ka ardhur, thotë librarja, një ish shefe kuadri e nomenklaturës, bëhen pesë vetë, vënë nga 100 lekë dhe blejnë, gjoja, librin, e lexojnë njëri pas tjetrit, e kthejnë përsëri dhe tërheqin paratë.

Një nga librat e mi me poezi; «Bukë dhe verë» si dhe dy romane, flenë gjumë në një cep të shtëpisë së vjehrrës në Tiranë. Libraritë nuk e pranojnë poezinë, sepse ajo nuk u shitka më. Ndërsa romanet duhet të jenë përkthime. Megjithë këto vështirësi, libra botohen me shumicë. Emra të rinj, që krahasohen me Borhesin, Heminguejn, Markesin. Para emigracioni, mall i sëmurë emigracioni, që shndërrohet në libër dhe famë të rreme. Shtohen shtëpitë botuese, njëra pas tjetrës, si kërpuhat pas shiut, të ushqyera me mallin e përvëlur të emigrantit, që i beson ëndrrës, thyen gurë, pastron plehrat andej, që të paguajë ëndrrën këtej. Mua më ka lënë dëshira për të botuar. Më duket një gjë pa kuptim. Në malin me botime asgjë nuk ndodh. Bashkë me librat e këqij humbasin dhe librat e mirë. Një ditë një i panjohur kishte ngjitur nëpër muret e Bulevardit te Madh një afishe ku lajmëronte për një gjeni të ri shqiptar, që flinte në një papafingo ngjitur me *Kullën Eifel*, i cili ishte shpallur kandidat për çmimin *Nobel*. U morën ca gazeta tri ditë me këtë fakt, pyeten, po s'morën përgjigje. Afishja u gris si çdo afishe dhe nuk ndodhi asgjë. Poetët mbushin nga një çantë me libra dhe i shesin nëpër kafene. Një ditë dikush tha: Po vjen ai. Kush, pyeti tjetri. Ai që i bën paratë libra, poeti, shiko mban gjë libra në duar? Po. Shpejt t'ia mbathim, se ai t'i lë në dorë. Kjo është gjendja, duke lënë mënjane pompën e panairëve dhe koktejet për kryeveprën e radhës. Asnjë s'e çan, të gjithë duan të fitojnë dhe të gjithë duan të humbasin. Më mirë të mësohesh, në mënyrën më spartane, të ndjesh kënaqësi nga shkrimi dhe të harrosh dhunshëm kënaqësinë e botimit. Sepse është e kotë. Kur më thonë letërsia e sotme shqiptare, unë shoh një kaos. Kaos. Po në këtë krahurë rroposen e përdhosen ndoshta përgjithmonë libra të mirë dhe shumë të mirë. Amen!

XH. LL. - Keni vendosur të mos botoni më?


R. GJ. - Mbajeni mend këtë pyetje dhe ma përsëritni. Prej përvojës sime jam bindur se s'ka më bukur se shkrimi, botimi është i huaj, s'të takon. Kështu më duket se nga ëndrra e krijimit del në arenën e realitetit, që është një materializëm aq i vrazhdë sa të humbet besimi te vetja. Po me mua pati një deriçkë që më nxori çuditërisht në një botë Lize. Me një fjalë unë përjetova për një kohë të gjatë që vazhdon edhe sot një mrekulli me një botues në Kosovë dhe ky quhet Abdullah Zeneli, themelues i shtëpisë botuese *Buzuku*. Ai më botoi romanin e parë, *Darka mistike* në vitin 2000. Ishte shumë entusiast, me priti bashkë me gruan, Hanën, në Prishtinë, te Grand, madje kishte porositur dhe një violinist që i qante partiturat klasike. Pastaj bashkëpunimi ynë vazhdoi me romane, tregime, poezi. Po ishte dhe një tjetër këtu në Tiranë, pikërisht ju që po më merrni në intervistë, Xhevair Lleshi, botuesi im dhe miku im, këmbëjmë shumë *email* bashkë dhe mendoj se ato janë letërsi më vete. Ka vendosur të më botojë kompletin e veprës sime dhe të më organizojë 70 vjetorin në verë në Tiranë. Keci në prush, ferlik, do të jetë balli i menysë.

XH. LL. - Atëherë po jua përsëris pyetjen: Keni vendosur të mos botoni më?

R. GJ. - Me ndërgjegje, po, ndonëse është e gënjeshtërt, shkrimtari nuk e mban fjalën. Nuk të lë ai bir kurve që e ke brenda e të nxit; e, jepi, ose dështo, ose qëndro në këmbë. Suksesi nuk ka, ai është i përkohshëm. I duhet lënë kohës gjithçka. Po veç asgjë nuk ndodh me librin sot. Asgjë. Ai veçse shkruhet, botohet dhe vdes. Ndoshta për t'u ringjallur dikur. S'ka kurrfarë politike për librin, ai shikohet si diçka që s'i hyn në punë instancave që duhet të merren me të. Ku janë bibliotekat, antologjitë e letërsisë, të paanshme dhe të vërteta, ku janë kritikët, jo miqtë, ku janë... të pafundme këto. Ku janë? Për këtë shkak, unë shkoj shpesh në kishë. Në një kishë amerikane: *Tre ditët e Krishtit* (kur ai u ringjall). Atje lutem dhe ndez një qiri për librin.

XH. LL. - I dëgjoni kambanat?

R. GJ. - Ato bien për të gjithë. Çfarë presim? Është koha kur nuk ka më apostuj, se të gjithë janë bërë perëndi, thotë fjala e urtë. Po unë kam besim, se besoj te lutja. *Letërsia është Shën Llazari i fashuar. Ai vdes dhe ngjallet përsëri.*



PROZA E TË MALLKUARIT

NGA ISMAIL KADARE



Portreti nga Ina Lajthia

Në pothuajse të gjitha gjuhët e botës gjendet shprehja “tokë e nëmur” e, në shembullim të saj, “popull i nëmur” e “ditë e nëmur”.

Pra, qysh në lashtësi mendja njerëzore e quajti të natyrshme t’ia bashkangjisë hijen e rëndë të mallkimit tre elementëve themelorë: tokës, kohës dhe njeriut. Në shekullin e XIX-të Paul Verlaine krijoi togfjalëshin “artist i mallkuar”, që do të shërbente si karakterizim i një brezi të tërë poetësh, ndër të cilët më të shquarit ishin Arthur Rimbaud dhe Charles Baudelaire.

Shprehja e Verlaine-it hynte ndër ato mrekulli të errëta të gjuhës, që paralajmëronin fatkeqësi të ardhme. Shkrimtarët “e mallkuar”, qoftë në Francë, qoftë në vendet e tjera evropiane, e përjetuan në mënyra të ndryshme gjendjen e tyre të veçantë, disa në trajtë vetëvuajtjeje, të tjerë duke e kthyer mallkimin në njëfarë ekstaze krijuese, e ndonjë si Oscar Wilde, e pagoi me çnderim e burgim të rëndë. Megjithatë, në atë kohë, as ata vetë e as të tjerët që u morën me ta, qoftë ithtarët e zjarrtë e qoftë kundërshtarët plot helm, nuk e parashikuan dot se pesha e mallkimit, në vend që të zbutet, do të zymentohej edhe më në shekullin e ardhshëm, në shekullin XX. Për të qenë më të saktë duhet thënë se ndodhi diçka e habitshme, krejtësisht kundërtshënës, një nga ato dukuri që dëshmojnë se jeta e letërsisë dhe e artit rrjedh sipas ligjeve të ndryshme nga ato të jetës njerëzore. Në shekullin e XX pra, kur shkrimtarët e nëmur njëri pas tjetrit po çliroheshin nga nëmia e po zinin vendet e tyre, gjer atëherë të mohuar, në tempujt e panteonet letrare, mallkimi befaz u përtërit, në mënyrën më të papritur. Ai u projektua tashmë jashtë tyre në popuj e hapësira të tjera, në trajtën më të zezë që mund të mendohej. Në gati gjysmën e botës, në atë që quhej “perandori komuniste”, shkrimtarët e mallkuar e rifituan vulën e tyre ogurzezë. Ata vetë ishin të mbrojtur tashmë nga vdekja dhe fama që në vendet e tyre sa vinte rritej, por kjo nuk pengonte aspak që mekanizmi i mallkimit, ashtu siç përfytyrohej nga popujt e lashtë, të punonte edhe më fort. Tërbimi kundër këtyre shkrimtarëve, djegia, ndalimi i tyre, ishin vetëm një pjesë e së keqes. Pjesa tjetër e mallkimit, ajo më e tmerrshmja, ra mbi lexuesit e tyre. Dhjetëra, mijëra njerëz në botën komuniste u përdoqën, u burgosën, u torturuan, e disa herë u grinë barbarisht me plumb vetëm se patën guximin ose pakujdesinë të lexonin, të përkthenin a të kujtonin në ndonjë pasdarke vargje të poetëve të nëmur. Bota kishte njohur edhe më parë ndalime librash shoqëruar me ndëshkime të ashpra, por ishte herë e parë që raportet shkrimtar-lexues merrnin në një shkallë kaq të gjerë një ngjyrim të tillë tragjik.

Lexuesit martirë të botës komuniste, lexuesit me emra të panjohur, që stuhia e kohës i gëlltiti në terrin e

saj, bëjnë pjesë në sferën ende të pandriçuar të historisë së letërsisë botërore. Për këtë holokaust letrar është folur ende pak. E në këtë holokaust kanë pa dyshim vendin e tyre edhe lexuesit shqiptarë.

Ndaj botimi në gjuhën shqipe i prozës së Charles Baudelaire-it, një ndër figurat qendrore të letërsisë së mallkuar, është më shumë se një ngjarje letrare. Ajo është pjesë e vuajtjes shqiptare, pra pjesë e historisë së saj.

Charles Baudelaire u lind më 1821, në të njëjtin vit që erdhën në këtë botë Dostojevski dhe Flaubert-i. Jeta e tij ishte e shkurtër dhe e trazuar. I ngrysur, i ftohtë me familjen, “shpirt që ndriçohet prej afrimit të fatit të keq”, siç e ka krahasuar një bashkëkohës, me borxhe qysh në rini, me një tundim vetëvrasjeje, i joshur nga droga, nga viset e largëta, nga një vajzë mulate, që do të ishte dashuria kryesore e jetës së tij, shëndetdobët, i pavullnet, i torturuar nga sifilisi, dhe së fundi, si të mos mjaftonin të gjitha këto, i prekur nga çmenduria, ai vdiq në moshën 46-vjeçare, pothuajse i paralizuar dhe i pagojë.

Siç ndodh shpesh në jetën e krijuesve, e gjithë kjo ngrehë e zymtë e jetës së tij ngjante si e përgatitur enkas për të ndihmuar krijimin e një veprë që do të ishte në harmoni me të. “Ju jeni i qëndrueshëm si mermeri dhe

i tejdukshëm si një mjegull e Anglisë”, i shkruante në një letër Flaubert-i.


Më 15 mars 1866, ndërsa vizitonte një kishë, Baudelaire u shemb papritur përdhë. Ishte kjo rënie e cila ia paralizoi gjymtyrët, pa ia prekur mendjen. Ndërkaq, duhet thënë se përpara se të ndodhte kjo goditje, që shumëkujt do t’i ngjante si një ndëshkim qiellor, Baudelaire qysh herët e kishte marrë kërcënimin tokësor të njerëzve: vepra e parë e rëndësishme e tij, përmbledhja poetike “Lulet e së keqes”, fill pas botimit më 1857, u godit nga një proces gjyqësor, i cili e dënoi shkrimtarin për imoralitet, duke e ndëshkuar me gjobë dhe me censurimin e 8 vjershave.

Proceset gjyqësore nuk do t’u ndaheshin “të mallkuarve”, që nga ato që lidheshin me kacafytjet kafeneve të Verlaine-it me Rimbaud, gjer te dënimi i Oscar Wilde për homoseksualitet, i vetmi në koleksionin e veseve, siç quheshin atëherë, që Baudelaire nuk e njohu. Ndërkaq, duhet thënë se gjyqi kundër “Luleve të së keqes” ishte një tmerr, përmasat e të cilit do të projekttoheshin, siç u tha më lart, në të ardhmen. Njëqind vjet më pas, kur dhjetëra-mijëra shkrimtarë të botës komuniste do të zvarriteshin nëpër burgjet dhe baltrat e Kinës, për një përkim ogurzi, qëllloi që në këtë hetakombë të pashembullt gjendej prapë fjala “lule”. (Të lulëzojnë njëqind lulet!)

Poezia e Baudelaire-it u quajt imorale jo në mënyrë tinzare, për të fshehur një shkak tjetër, ta zëmë politik, çka do të ndodhte shpesh më pas. Ajo u quajt e tillë ngaqë ashtu ngjante dhe ashtu ishte për moralin e kohës, pra si rrjedhojë e një keqkuptimi tragjik për artin.

Vetë shkrimtarët e “mallkuar”, jo vetëm që nuk deshën të përlligjin asgjë për veprën e tyre, por me dëshirë shkuan drejt lëçitjes dhe mallkimit. “Unë e kultivoj histerinë time me ngazëllim e tmerr”, shkruante Baudelaire në ditarin e tij intim. Në këtë rendje drejt bujës e skandalit, atje ku dukej se ishte strehuar forca e tyre, pikërisht atje, bashkë me të, ishte strehuar edhe brishtësia. Krijuesit e mëdhenj, ata, mendja e të cilëve punon në sferat sipërane të artit, vetvetiu i shmangen përzierjes së jetës së tyre të përditshme me aventurën e madhe të krijimit. Me fjalë të tjera, duke qenë të detyruar të jetojnë jetën njerëzore, qoftë me shkëlqimin e luksin, qoftë me mizerjen e saj, ata s’mund t’i marrin seriozisht as njërën as tjetrën, e aq më pak të vetëmahniten a të vetëvajojnë për to. Shkurt, sfida e tyre ndaj epokës zhvillohet në përmasa të tjera dhe vështirë se mund të ketë gjë të përbashkët me modën kalimtare, me përndejetet e kafeneve, me lavdinë e dyshimtë, që mund të vijë nga përdorimi i drogës, apo përkëdhelja e amoralitetit.

Shkrimtarët e “mallkuar”, e kryesisht Baudelaire,



të tërhequr nga ai që u quajt “dandizmi në letërsi”, krijuan përshtypjen te shumëkush se u dhanë më shumë se ç’duhej pas gjërave, që mund të ishin tërheqëse e joshëse për njerëzit e rëndomtë, por kurrësi për krijimin e madh. Duke patur një përbuzje të ligjshme për gjërat e rëndomta e për vulgaritetin, u duk sikur ata ranë vetë në kurthin e tyre.

Kështu shpjegohet ndoshta që, duke qenë të rëndësishëm si dukuri e si grup shkrimtarësh, duke i dhënë poezisë franceze e asaj botërore perla të rralla e të papërsëritshme, nuk mund të thuhet se ndonjëri prej tyre u ngrit në lartësinë komplekse të Balzakut, për të marrë një shembull francez, e aq më pak në atë të familjes së gjenive të tillë si Dante apo Shekspiri.

Kjo nuk cenon asgjë në peshën e tyre, e as që e vë në dyshim atë, që Baudelaire të quhet si prijës i letërsisë moderne franceze. Përkundrazi, është pikërisht kjo që ndoshta shpjegon më së miri tiparet e kësaj letërsie sot.

Historia e zhvillimit të letërsisë botërore mbetet përherë e ndërlikuar dhe shpesh misterioze. Shkëlqimet e saj, siç qëllon që shfaqen nëpërmjet një gjeniu të vetëm, po ashtu mund të shfaqen nëpërmjet një grupi. Madje edhe ky i fundit qëllon që nuk arrin të japë vetë vlera të njëmendta, por përgatit ndërkaq klimë të ardhshme e horizonte të reja, dhe mbetet i rëndësishëm. Për të bërë një krahasim që mund të plagosë natyrat e ndjeshme, mund të thuhet se, ashtu sikundër në kërkimet e naftës, kur shpimi i puseve edhe kur nuk jep asgjë quhet një sukses, ngaqë i çliron kërkuesit nga një iluzion, edhe në kërkimet letrare, qofshin të pafrytshme aty për aty, gjëllon shpesh fara e vlerave të ardhme. Thesari letrar botëror mund të përfytyrohet kështu në një pamje të tij të plotë bashkë me pjesët e tij të aspakta, domethënë me ato gropa e zbrazëti që s’kanë emër, por që u flijuan për të përgatitur emrat e mëdhenj. Shembull i fundit për këtë ka qenë historia iluzore e “romanit të ri”, ajo që qysh tani bën pjesë në varrezat e letërsisë, e për të cilën, megjithatë, askush nuk mendon se ka qenë e kotë.

“Shkrimtarët e mallkuar” patën si rrallëkush fatin e dyfishtë të krijonin vlera të njëmendta e të hapnin horizonte të reja. Baudelaire ngulte këmbë në “sipëraninë e përjetshme të dandit”, ndonëse dandizmi në letërsi s’mund të ishte veçse një iluzion në radhën e iluzioneve të shumta. “Mallkimi”, dandyzmi, pirgu i fildishtë, stili mandarin etj. të gjitha këto kaluan si valë përqethëse në letërsinë evropiane, duke përshkënditur në veprat e Flaubert-it, Nerval-it, Wild-it, Moor-it, Eliot-it, Woolf-it, Proust-it, e gjer të Joyce-it. Në të gjithë këtë rrjedhë trazuese ndihet shqetësimi i shkrimtarëve për të mbrojtur letërsinë nga sulmi i vulgaritetit dhe i së rëndomtës, shqetësim i përjetshëm i krejt racës së shkrimtarëve. Letërsia kështu ka lindur qysh para tre mijë vjetësh, bashkë me instinktin e saj mbrojtës: të jetojë sa më gjatë në këtë rruzull të egër që quhet tokë. Dëshira për drejtësi, ajo që Cyril Connolly i kohës sonë e ka shprehur me fjalët “që libri të jetojë pakëz më shumë se një qen, ose një veturë, ose afati i një huaje bankare”, është bazike te të gjithë krijuesit. Shkrimtarët sqimatarë (elitistë, mandarinë, pirgofildishienë, parnasienë etj., etj.), prijësi e pararendësi i të cilëve mbetet pa kurrfarë dyshimi Charles Baudelaire, sikur të parandienin mësymjen e tmerrshme që letërsia do të pësonte në shekullin që po vinte prej turmave vulgare, shpejtuan të forconin ledhet e saj mbrojtëse. Atë që ata nuk e kapën ndoshta plotësisht, ishte se letërsia botërore i kishte patur përherë ato ledhe, ngaqë pa to as që mund të jetonte. Letërsia e vërtetë ashtu edhe kishte lindur: zonjë e madhe, me sqimë të madhe, e jo të rreme. Ajo nuk e kishte ndarë kurrë atë që quhej “zonë hyjnore” nga zona e përditshme e jetës. Falë kësaj, letërsia e vjetër greke përballoi mijëvjeçarët. Dante Aligheri i përzieu



këto dy zona në ferrin e tij, Shekspiri në kështjellat e zymta skoceze, kurse Servantesi brenda trurit të krisur të Don Kishotit.

Në jetën e shumicës së shkrimtarëve ia beh gjithmonë një kohë kur atyre u duket se gjinitë letrare (ose më saktë, ato që mendja jonë e gjymtuar nga gjithfarë trysnish i quan kështu), janë një veshje penguese për ta. Me të drejtë ata rebelohen kundër tyre, përpiqen t’i ndryshojnë, t’i zgjerojnë, t’i pasurojnë, me fjalë të tjera t’i thyjnë. Përfundimi shpesh është i kundërt me ëndrrën e tyre: janë ata që në shumicën e rasteve thyhen e jo gjinitë. Shpjegimi është i thjeshtë: nervozizmi kundër gjinive letrare është shpesh më i bujshëm te shkrimtarët e mesëm sesa te krijuesit e mëdhenj. Të parët, duke mos qenë të aftë të japin vlera të mirëfillta askurrkund, i ndërrojnë gjinitë shpesh e, duke i braktisur, i fajësojnë gjithë mllef e pa dyshim i bëjnë shkaktare për çdo dështim. Të dytët, krijuesit e mëdhenj, kanë marrëdhënie harmonioze me gjinitë, dhe ndonëse ato kostume shekullore qëllon që i shtrëngojnë, ata dinë të merren vesh me to. Kjo është e natyrshme ngaqë letërsia e madhe botërore kështu ka lindur: në një përzjerje, apo më saktë, marrëveshje midis atyre që do të quheshin më pas gjini. “Iliada” lexohet po aq si roman, sesa si poemë epike, si kronikë e një lufte, ose si dramë me shumë akte.

Proza e Charles Baudelaire është shembull i harmonisë krijuese brenda universit të një shkrimtari. Duke mos qenë as rastësi, as trill e as dëshirë për freskim, e aq më pak dyzim i poezisë së tij, ajo është pjesë themelore e botës bodleriane.

Baudelaire shkroi në prozë për një kohë tepër të gjatë dhe proza e tij është jo vetëm vazhdimësi, por edhe risim i krejt veprës së tij.

Ne nuk mund ta dimë kurrë, e qëllon që as krijuesi vetë nuk e ka të qartë gjer në fund shtysën e vërtetë për të kaluar nga një gjini letrare te tjetra. Për krijuesit e mirëfilltë, ajo urdhërohet në sferat e larta, të fshehta të krijimit, ndaj edhe shpjegimi për të mbetet gjithmonë i mangët. Shtysa e Charles Baudelaire-it drejt prozës mund të ketë lidhje të natyrshme me dufin e tij sfidues ndaj botës, me sqimën, me përçmimin ndaj së rëndomtës, së fundi, me prirjen për blasfemi e satanizëm. Në vështrim të parë ngjan disi kundërtëdhënëse që elitizmi të të çojë drejt prozës,

por po të hetohet më thellë bëhet e qartë se, pikërisht në prozë shpaloset më mirë kundërtia midis shfaqjes banale të jetës dhe thelbit të fshehtë, shpeshherë misterioz, që është ndryrë brenda lëvozhgës së saj. Në rrëfimin e një endacaku parizian, te hyrja e një restoranti, te një grumbull lavresh që qeshin ose që rrihen prej dashnorëve, shkrimtari kërkon të zbulojë një tjetër gjë, ai kërkon të bëjë një zbritje ose një ngjitje danteske, për të patur kështu mundësi për një vizion të madh.

Natyrisht që të gjitha këto duken se janë “punë të poezisë”, por Baudelaire ndaj është sfidues, përçmonjës e kërkues, ngaqë për të na trandur, apo për të na plagosur më fort, e zbulon “zonën qiellore” atje ku ajo është e fshehur më mirë: në baltën e së përditshmes.

Proza e Charles Baudelaire-it botohet për herë të parë në gjuhën shqipe. Në botimet frëngjisht, që u bënë kryesisht pas vdekjes së tij, midis titujve të shumtë të lënë prej autorit, *Poezi nate*, *Brenga e Parisit*, *Endësi i vetmuar*, *Poezi të vogla në prozë*, u zgjodh kjo e fundit që mori në njëfarë mënyre miratimin e kritikës universitare. Meqenëse fjalët “poezi në prozë” ose “prozë poetike”, në vendet e ish-perandorisë komuniste lidhen me kujtimet e kohës kur pikërisht në këtë gjini letrare u bënë edhe shpërdorimet më të shumta për vulgarizmin e letërsisë, në emër të masivitetit të saj, u mendua që në botimin shqip të zgjidhej një nga titujt e tjerë: “Brenga e Parisit”. Mund të thuhet se përkthimi i prozës së Baudelaire-it në gjuhë të ndryshme ka qenë shpesh më i vështirë se ai i poezisë së tij. Kjo vështirësi ka lidhje pikërisht me vizionin elitist të shkrimtarit. E panatyrshmja, droja e dhunimit të artit prej realitetit, duke bërë pjesë në thelbin e kësaj proze, shprehet edhe në veshjen gjuhësore të saj. Ndaj ka qenë e kuptueshme mëdyshja e përkthyesve të shumë vendeve për të zgjedhur midis besnikërisë së plotë ndaj autorit dhe një lirie që do të synonte një tingëllim më të natyrshëm në gjuhën e përkthyer. Kjo e fundit, e zgjedhur prej shumicës së përkthyesve, do të ishte një dhunim në rastin e Baudelaire-it. Ndaj në gjuhën shqipe, ashtu si në përkthimet anglisht, u parapëlqye në këtë botim të parë, besnikëria.

EPILOG

Sot zemër lehtë jam ngjitur te kjo bregore e bukur
Prej ku qyteti duket i shtrirë skaj më skaj
Spitali, purgatori, bordelli, ferri, burgu,

Ku marrëzia e njerëzve shpërthen si një lunajë.
Ti e di mirë, Satan, o zot i brengës sime,
Se unë s’vij këtu si qaraman të qaj;

Por si bandilli plak që vjen tek mikja plakë
Nga kjo lavire e trashë kam qejf të dehem thumb
Prej mishit skëterror të saj të ndizem flakë.

I fjetur qofsh, në ag i shtrirë gjithë përtaci,
I rëndë, i terratosur, me rrufë a i ngrefosur
Në vellon mbrëmësore spërkatur me flori,

Të dua, ashtu si je, o horr kryeqytet!
Laviret dhe banditët na japin shpesh ca ëndje,
Që leshkot e pafisëm s’i kapin kurrë në jetë.

PËRKTHEU: ISMAIL KADARE

1.

Duke pritur kohën e ardhshme, humba pa ditur ku jam e kush jam.

Për ta ruajtur distancën nuk po di se çfarë dua.

Kjo e panjohur po më tremb, po më shqetëson.

Kohë e rrezikshme e unë ende po mendoj se është koha ime...

Humbja qenka diçka që nuk e kam ditur.

Diçka që deri më tani nuk më ka ndodhur.

Sot vetëm çmenduria e ka një kuptim - vështirë për t'u thënë e për ta treguar.

Besoni apo jo, s'ka njeri që beson.

Si mund të besojmë?

Kot e dogjëm historinë.

Përpjekjet e njeriut për të dalur në anën tjetër janë të njohura, për më shumë detaje një brez ende i palindur më pyeti:

"A mund ta shohim një fotografi dokumentare dhe mandej e ndajmë mendjen për po apo për jo?! Kemi edhe diçka tjetër për të thënë e për të pyetur.

E vërteta si e vërtetë a e ka humbur shkëlqimin dhe kultin antik?"

Kërkojeni historinë e pashkruar, u thashë.

Sot të gjitha idetë, përsëritjet i ha pazari.

Çmimi është pyetje naive.

Kërkesat na çojnë deri te kronikat e zeza.

Gjatë Darkës së Fshehtë e pas Darkës së Fshehtë të njerëzve pa fytyrë e pa identitet, jeta bëhet pothuajse e pajetueshme.

Truri i njeriut të shëndoshë nuk e pranon.

2.

Ky shekull, duke ikur nga Shekulli i Madh, me krahë që hapen e mbyllen na ka futur në qorrrokak.

Me besim të verbër.

Para se ta harrojmë fillimin, rreziku mund të jetë më shumë se kaq.

E ndjej dhe e di.

Diçka harrohet dhe diçka digjet kot.

Në fillim, sapo u njohëm, mu duk se dikush më pret.

Ku është fillimi?

Nuk e di ku është fillimi.

Më thanë se fillimi po ikën ose po shkon për të ruajtur distancën.

Për një kohë tjetër harrova pse bëhet lufta.

Humbja po më flet dhe po më shqetëson.

Na ka ndodhur diçka.

Vetëm çmenduria e ka një kuptim.

Më falni, çmenduria është një keqkuptim.

Para se ta harrojmë m'u duk se dikush më tha:

"S'kemi pse të themi: armiku! Për të rënë në tokë armiku është koha e saktë që kalon mbi kokat tona e ne me kultin e legjendave ende besojmë se armiku është afër e larg. Me të zezat e pazbardhura. Duke e provokuar edhe veten, me dy mendje deri në çfarë shkalle do të hipin e zbrësim, nuk kemi shënime."

Jeta vjen e shkon.

Ne nuk po e shohim.

Po plakemi para kohe.

3.

Sa herë mendoj se bukuria ekziston, më vjen të ik nga koha e tashme.

Si një pikë uji humbi në shkretëtirë.

Me nostalgjinë e poezive romantike, nga shkretëtira shikoj hënën.

Drita e saj më bëri magji.

Njëherë e pyeta:

"Kush është i pari për ty? Ku shkoi ajo bukuri? Çfarë qetësie e çfarë guximi për ty që je një mrekulli?!"

Hëna më dëgjoi dhe heshti. Më dëgjon dhe më buzëqesh.

Dhe vazhdoi udhëtimin nëpër hapësirë.

Ndoshta vetëm mua më duket.

Para nurit të saj edhe unë heshta.

U bëra i mirë.

Vetja m'u duk se jam tjetër njeri.

Të gjitha ato gjëra që më kujtohen, ku do t'i çoj?

Ku do t'i ruaj.

Për botën e sotme mashtrimi është ajo që e kemi dashur.

Me dëshirë do të na shoqërojë deri në fund të rrugës.

Edhe humbja duhet ta tregojë veten.

Edhe pse ende kemi frikë se ku po fillon e ku po mbaron ky mashtrim, jetës po i themi: kërce se po të paguaj!

Një dy, tre...

Vendosa të shkruaj nga kjo kohë për një kohë tjetër.

Vjedhja e zjarrit është art...

Edhe kur gabojmë gjejmë diçka që e kemi humbur kot.

Kush po thotë se njeriu beson, se jetohet edhe pa identitet?!

Vitet e çmendurisë nuk kanë probleme me largpamësinë.

Të dhënat e harruara i gjejmë atje ku shkojmë për t'i fshehur gabimet.

Gabimet që nuk kërkojnë diçka më shumë se një ëndërr mashtruese.

4.

Kush e bëri historinë?

Për çfarë lufte?!

Kur jemi larg historisë mbyllet një histori.

Edhe Lufta e Trojës është bërë legjendë.

Ndoshta edhe asaj lufte e atyre heronjve u erdhi fundi.

Nuk na lejohet të shkojmë aq larg.

Më shumë na pëlqen fillimi me prostitutat politike e fotografi pornografike.

Kush do të luajë e kush do të paguajë?...

Mos u shqetësoni.

Ende jemi mirë.

Koha është lumë.

Për kohën e ardhshme ndoshta vjen një shekull tjetër nga e keqja e quajtur jetë.

Kur vjen nuk e di a na gjen.

Me të larat e të palarat tona a është dikush që na pret.

Më mirë është që nuk e dimë.

Do të kthehem shpejt, besoj.

Me adresë e pa adresë, besimin e gabuar e kemi për paturpërsi dhe kob.

Për zotin e humbur le të ketë Zot.

5.

Çka na gjeti?

Nuk është e lehtë për ta kuptuar.

Zoti na ka braktisur.

Me harresën e një çmimi të lartë për ne.

Për punët tona të shpifura nuk deshi më shumë të na fajësojë e të na turpërojë.

Me zhurmën për ta ndryshuar traditën.

Me zhurmën për ta vjedhur famën e thesarit kombëtar.

Me zhurmën për besimet e humbura

Dhe me zhurmën për të vjedhur tokën nga toka.

Si ndodhi nuk merret vesh.

Viktima e parë do të jenë fëmijët ende të palindur.

Mbylleni derën e mbyllur.

Kjo është ajo vetmi që na pret.

Ç'thotë bota?!

Bota për ne nuk di si të flasë as si të heshtë e as si të del nga lëkura e vet.

Besimi në Zot na ishte lidhje fizike dhe lidhje shpirtërore për jetën e dashur.

Tani ku dreqin është njeriu?!

Ndoshta më s'është për t'u parë.

Për t'u parë s'ke çka me pa.

Nuk bënë m'u parë.

Ç'po pyet?

Ç'po kërkon?!

E – ç'po pret?!

Pas luftës së fundit e pritëm Liri dhe Gëzim.

Por i gjithë ai gëzim na doli mashtrim.

Në pikë të ditës patriotët tanë të rrejshëm, me teze e dajë e djallarë e hapën rrethin.

Ëndrra e tyre filloi të pasurohet çdo ditë e më shumë.

E populli me dashin e zotërisë si kurban që e mban mbi shpinë pret ditë më të mira...

Me rrezikshmëri të madhe për të ardhmen e fëmijëve të vet...

6.

Po ku është njeriu?

Për t'u parë me varfërinë shpirtërore mbi peshën e tokës si ta kuptojmë?

Nga ajo që kam parë, po më vjen të pyes:

A duhet të presim?

Nuk e di se çka duhet të presim!

Jetën po e shohim përditë në pasqyrë.

Si karikaturë.

Si maskë.

Ndoshta është ëndërr.

Ëndërr që nuk harrohet.

Ëndërr që nuk përsëritet.

E pabesueshme për të besuar.
 Larg dhe afër mashtrimeve.
 S'kemi asnjë adresë tjetër.
 Mbi fatin tonë çdo gjë po kalon me paturpësi.
 Për këtë të vërtetë na dolën edhe brirët.
 Kë do ta takojmë.
 Me zemër të mirë asgjë nuk bëhet më shumë se një monedhë.
 Për shpirtin e varfër mos u fshihni.
 Çfarë doni të dini?
 Është për të ardhur keq!
 Kjo paturpësi është e vetmja ëndërr që po na kujtohet.
 Më vonë koha e ardhshme shkon e vjen si flaka e kandilit.
 Me pak avanturë të çmendur.
 Në një shesh, para shtatores së heroit kombëtar.
 Popullit të gjorë djalli i tha:
 "Vazhdoni, vazhdoni! Çmenduria ndoshta dikujt i pëlqen. Për të dy anët është ëndërr mashtruese".

7.

Nga një dëshirë e papërmbajtur, e papërcaktuar, duam të argëtohemi.
 Të argëtohemi e të çmendemi.
 Kemi qenë mjaft të mirë e mjaft të njohur e mjaft të kuptueshëm.
 Shpesh me maska për ballo romantike dhe maska të frikshme për mashtrime.
 Për hollësitë e tjera është miku o armiku.
 Në sheshin e rrumpallës çdo gjë e ka fundin dhe fillimin.
 Për famën e rrejshme e kemi shitur edhe shpirtin, edhe varrin.
 Për të shtënë diçka në dorë, sa kushton poshtërimi s'pyet kush.
 Me lot krokodili e bëjmë edhe një udhëtim.
 Më thanë: Fol, por mos i premto asgjë askujt.
 Kur jemi larg historisë, për mundësitë e humbura mbyllet një histori.
 Më vonë gjejmë diçka që e kemi humbur.
 Për inat të atyre që e dijnë për çka bëhet lufta, si u bë që na erdhi kjo kohë.
 Nga dashuria e madhe duhet të mendohemi.
 Kend ta vrasim.
 Ëndrrën mashtruese e kemi kuptuar.
 Nuk e di as vetë pse.
 Na duhet diçka edhe më e çmendur se çmenduria!...

Nëntor, 2019



VEPRA E PLOTË E AKADEMIKUT REXHEP FERRI PANAIRIN E TIRANËS

Rexhep Ferri

HUMBËSI I LUMTUR

Poezi



Onufri

Rexhep Ferri

NDOSHTA
DASHURI

Poezi




Onufri

Rexhep Ferri

ATDHEU IM TORZO

Roman



Onufri

Rexhep Ferri

NJERIU
PO KUSH TJETËR

Roman



Onufri

Rexhep Ferri

FRIKË NGA
GUERNIKA

Roman



Onufri

Rexhep Ferri

BRITMA E MUNKUT

Roman



Onufri

Rexhep Ferri

PORTRETI
NË MONEDHË

Roman



Onufri

Rexhep Ferri

GABIME
TË BUKURA

Ese



Onufri

Rexhep Ferri

ORA ME QYQE

Ese



Onufri

"Rexhep Ferri ecën drejt të qenësishmes brenda barazpeshës së masave, të elipsave, të lëvizjeve që kryqëzohen. Ai e ka ndjeshmërinë dhe dhuntinë për të përdorur kështu një gjeometri skajshmërisht të kuptueshme, ku ndeshen, do të thoshim, gravitacionet e tokës dhe të materies... Duke u shkëputur nga rrethanat, Rexhep Ferri ka ditur mjaft mirë të sigurojë universalitetin e tij dhe kjo më le mbresën më të qëndrueshme".

Alain Bosquet

Paris, 1 shtator 1977

FJALORI FRAZEOLOGJIK ANGLISHT-SHQIP, I PROF. DR.ESHREF YMERIT, NJË MONUMENT NË FONDIN E ARTË TË KULTURËS KOMBËTARE

nga Vilhelme Vrana Haxhiraj



"Gjuhën shqipe kam NËNË DHE BABË!" E.Ymeri

Eshref Ymeri është një personalitet dhe individualitet i veçantë i kulturës kombëtare, një erudit që ka dhënë vlera të pallogaritshme në fushën e gjuhësisë, të përkthimit dhe të publicistikës. Ai është autor dhe bashkëkohor që ka vënë një gur të rëndësishëm në kolanën e artë të kulturës kombëtare. I pajisur me dije të gjera, njohës i mirë i disa gjuhëve, me vullnetin që e karakterizon në punën e tij të palodhshme dhe vetmohuese e ka renditur veten në elitat e kombit. Ky personalitet i kulturës kombëtare, edhe pse insitucionet e larta shtetërore janë treguar dorështrënguar duke ia mohuar një të drejtë legjitime, Akademiku, "Personalitet i shquar i Labërisë" një nga Elitat bashkëkohore të kombit, Prof.dr.Eshref Hasan Ymeri, është "Mjeshtër i Madh" për lexuesin e gjerë.

Para pak ditësh u mrekullova me një vepër monumentale akademike, të sapobotuar, **"Fjalori frazeologjik anglisht-shqip"**, me autor **Prof. dr.Eshref Ymeri**. Fjalori doli nga botimi në nëntor 2019. Kjo vepër akademike ka 25 440 shprehje frazeologjike (anglisht, kurse në shqip ka mijëra shprehje frazeologjike), të cilat janë përfshirë në 1254 faqe. Nuk është vepra e parë monumentale e akademikut Eshref Ymeri, i cili herëpashere befason me punë të tilla vetmohuese, brilante dhe mbi të gjitha ka bërë një punë voluminoze, hulumtuese, shkencore, që këkon një vullnet të jashtëzakonshëm, cilësi që nuk i mungon profesorit. Ky fjalor është një vlerë e padiskutueshme për katedrën e gjuhëve të huaja, për lexuesit, studiuesit, përkthyesit, akademikët që dinë ta vlerësojnë. Veçanërisht është një vlerë e pallogaritshme në pasurimin e gjuhës shqipe, sidomos, Leksikologjisë si shkencë dhe një pasuri e madhe e folklorit. Për vepra të tilla me peshë në historinë e Gjuhës Shqipe që kërkojnë përkushtim, kohë, mund, dije dhe njohje të thella të gjuhës mëmë, si dhe të gjuhëve të huaja, zakonisht angazhohet Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Nëse Akademia do të punësonte një numër akademikësh, Prof Eshrefi e punoi i vetëm dhe e botoi me ndihmën financiare të fëmijëve. Për fat të keq ky insitucion, më i rëndësishmi në kulturën kombëtare, si "udhërrëfyes" i institucioneve Arsimore Akademike, ka rënë në gjumë letargjik.

Por a mund dhe a duhet të hesht Akademia e Shkencave, Katedra e gjuhësisë për një vepër të tillë, e para e këtij lloji në vendin tonë? Fatkeqësisht dhe çuditërisht këto institucione, për botime të tilla janë veshëvulosur, symbyllur dhe gojëkështur. Mjerisht u ka ngelur ora te veprat e Realizmit Socialist. Natyrisht ato "janë më të realizuara, sepse janë të diktuar". Kurse ky fjalor i pandarë nga krijimtaria e bollshme e cilësore e Prof.Ymerit, si dhe sa botime të tjera të autorëve të ndryshëm me vlera bashkëkohore, janë produkt i vetëdijes së lirë, ku ndërgjegjia ka arritur shkallën më të lartë. Një ndërgjegje e tillë gjendet te njerëzit me shpirt të madh dhe mendim të lirë. Kjo e dallon nga të tjerët sepse Ai u jep më të mirën e vetes,

nuk kursehet për të dhënë ndihmën e tij krijuesëve të tjerë, me bujari, çiltërsi dhe dinjitet. I tillë është Prof. Eshrefi, një individualitet me një formim e personalitet të admirueshëm, sepse ka fituar diçka të madhe, lirinë vetjake që nuk ndërvarret nga askush, nga asnjë lloj klani apo grupimi politik. Gjithsesi kjo nuk e pengon akademikun, eruditin, Eshref Ymeri që të tregojë se cili është apo deri ku arrijnë aftësitë e tij si studiues i mirëfilltë dhe i mirënjohur, linguist, leksikograf i shquar i Gjuhës Shqipe, si dhe i gjuhëve, rusisht, italisht, anglisht etj.

Prof.dr. Eshref Ymeri është bashkautor i disa fjalorëve dhe autor i dy fjalorëve Frazeologjik: **"Fjalorin frazeologjik rusisht-shqip"**, me 25160 shprehje, botuar në vitin 2015. Tani doli me **"Fjalor frazeologjik anglisht-shqip"**, me 25 440 shprehje.

Fjalori -anglisht shqip të josh qysh në pamjen e parë të tij, pasi është botim mjaft elegant, të cilin nga pikpamja estetike, pa frikë mund ta krahasosh apo ta quash një vepër arti klasik, por me përmbajtje moderne me baza shkencore.* Ky botim luksi, tejet i bukur, i një cilësie të lartë, që bie në sy të kujtdo e mbi të gjitha i punuar mjeshtërisht, është meritë e **Sh.B.'Bota Shqiptare'**, së cilës i shpreh mirënjohjen time!

Për realizimin e kësaj vepre madhore (Fjalor frazeologjik anglisht-shqip), veç punës së thellë studimore, hulumtuese dhe shkencore të Prof. Eshrefit në një afat kohor prej mëse 20 vitesh, duhen falënderuar bashkëpunëtorët e këtij botimi.

Së pari, përgëzoj dhe uroj bashkëshorten e Prof. Eshrefit, znj.**Hava Ymeri**, si korrektore jo vetëm në këtë fjalor, por dhe në veprat e tjera të tij, botuar më parë. Shpreh mirënjohjen time për dy gjuhëtarët: së pari shokun tim të shkollës pedagogjike "Jani Minga", të cilin e përhëndes përzemërsisht, shkencëtarin e gjuhës standarde shqipe, **Prof.dr.Rami Memushi** (redaktor).

Së dyti, përhëndes leksikologun, hartuesin e 11 fjalorëve, **Prof.dr. Hairi Shehu**, i cili si profesionist i mirëfilltë, ka bërë parathënien, duke vënë në pah vlerat e pallogaritshme që i jep ky fjalor shkencës së Leksikologjisë, një pasuri shumë të madhe. Për punën cilësore dhe profesionale të kolegëve. Prof.dr. Eshrefi u ka shprehur mirënjohjen e tij të thellë.

Në profesion nuk jam e profilit të gjuhësisë, gjithsesi dëshiroj të shpreh mendimin tim për rëndësinë leksikore, shkencore dhe atdhetare që ka ky fjalor. Fjalorë të tillë anglisht-shqip, rusisht-shqip, italisht-shqip, veçanërisht fjalorët frazeologjik, si pasuri e patundshme e kulturës kombëtare shqiptare, janë tregues se sa e pasur është gjuha shqipe nga pikpamja e leksikore. Pas leximit të veprave studimore të viteve të fundit (2012-2019), si, "Antologjia e Kryqëzimit", me autor, (Dr.Islam Lauka & Prof.dr.Eshref Ymeri), "Përkthimi, një histori pasioni" dhe veçanërisht "Arti gojor i përkthimit", një vepër studimore e rrallë, ku Prof Eshrefi ka shpalosur dije, kulturë, maturi politike, vepër që më hapi një horizont të gjerë dhe të ri në fushën e përkthimit gojor. Kur lexojmë një libër të

përkthyer nga gjuhët e huaja, na pëlqen duke na lënë veç mbresave, edhe një shije të përkryer ndijore nga përshtatja e përsosur drejtshkrimore. Veçse, si lexues kurrë nuk kemi vlerësuar punën e lodhshme, të vështirë dhe këmbëgulëse të përkthyesit, sepse është merita e tij që i bënë autorët antikë apo klasikë të flasin në gjuhën e bukur shqipe. Por e veçanta e Prof Eshrefit nuk janë librat e shumtë që ka përkthyer, aq më tepër ka qenë përkthyes gojor i politikanëve në këto 30 vite tranzicion. Ushtrimi i gjatë i përkthimit gojor, bëri të mundur që Prof. Eshrefi të realizojë librin studimor **"Arti gojor i përkthimit"**, ku përfshihen fjalimet e përkthyer të politikanëve më të mëdhenj të kohërave në botë.

Kujtoj se një fjalor i tillë krkon punën hulumtuese të shumë akademikëve, kurse Prof.Eshref Ymeri e bëri i vetëm

Duke u nisur nga vlerat që mbart një vepër e tillë, si fjalori, është domosdoshmëri dhe kulturë, që, së paku, Akademia e Shkencave, Institucionet Akademike, Ministria e Kulturës, Minsitria e Arsimit dhe Presidenca duhet të shprehnin mirënjohjen për punën shumëvjeçare të autorit, duke i dhënë vlerësimin e duhur. Gjithashtu është lexuesi, si kritiku më i paanashëm i krijimtarisë shkencore apo letrare, ai që duhet t'i jetë mirënjohës autorit për këtë dhuratë të vyer, që nuk ka çmim. Prof.Eshrefi, veç përkthimeve, si hartues i **teksteve mësimore universitare, Lëndëve mësimore praktike, Kurse leksionesh, Artikuj metodiko-shkencorë e shkencorë dhe Fjalorë.**

Prof. Eshrefi, Urime për Fjalorin, suksese në rugën e studimit, përkthimit dhe publicistikës.

Nuk di nëse munda të them sadopak nga vlerat e mëdha që kanë veprat tuaja...

I uroj jetë të gjatë dhe të suksesshme "Fjalorit frazeologjik anglisht-shqip"! Profesor, Ju uroj Juve dhe znj.Hava, jetë të gjatë në krah të njëri-tjetrit për vepra të tjera studimore akoma më madhore!Jam e bindur që Ju i arrini!

Me konsiderata të veçanta!

Familja Haxhiraj, Fitimi,Vilhelme ,Rezi; Ladi dhe Rainhardi (frymëmyrrja, Dielli, dhe Universi i nëna Vilit).

Vlorë, 7.11.2019





tregime nga

AGRON TUFA



SAJZA

Jam symadhja Sajza. Kam pasur sytë më të bukur në botë.

“Zanat e Korabit, - thoshte gjyshja, - kanë qenë të bukura, si ti. Por jo sa ti”.

Vdiq kur po mbushja 8 vjeç.

Tani jam bijë e ujit.

Rrjedh dhe bares - shpirt i trazuar ujnash.

Baba, që më vuri këtë emër, nuk e di se ku është. Nuk di a është gjallë. Për një gjë jam e sigurtë: nuk do të doja të ishte me ne... në këtë kamp... ta vinin këta policë në rresht... atë, një vigan kryenaltë, si majat me borë... ta ngarkonin me dru, si një kafshë.

Më pëlqen të mendoj se baba është larg...

Gjyshja na la e para. Mbeta vetëm me mamin. Po dhe mamin e shihja në mbrëmje, kur kthehej gjysëm e vdekur nga mali dhe barra e druve. Por dhe me mamin ndodhi një ditë diçka shumë e keqe: ia kishin gërvishtur lëkurën nën rroba dhe ia kishin kafshuar trupin me dhëmbë. Ndonjë bishë e egër mali duhet t'i jetë sulur, me siguri... sepse unë ia shihja gjurmët e dhëmbëve deri në gushë. Ajo i shtronte gërvishtjet me një pomadë. Pastaj, kur të gërvishturat po i zhdukeshin, iu shfaq befaz diç më e tmerrshme, që thanë se quhej “sëmundje toke”, ndoshta për shkakun se ajo binte në jermi, përpëlitej dhe gërvishtte tokën me thonj, derisa rraskapitej krejt e nxirrte shkumë të bardhë në cepat e buzëve. Asohere mama, s'di pse, niste të fliste një gjuhë të panjohur. Fliste me vete, pa iu drejtuar kujt. Nuk e dija se çfarë gjuhe ishte ajo. Askush nuk e kuptonte atë gjuhë. Asoherësh ajo nuk më njihje.

Një ditë e sollën në kaponon thuajse të vdekur. Gratë thanë se rrugës për në mal, e kishte zënë sëmundja e tokës e kish nisë me u hedhë përpjetë, duke ulëritur dhe, në atë gjendje, teksa hidhej e vërtitej në jermi, e kishte rrahur kapter Selfo me çizmet e tij të tmerrshme prej hekuri. Kur ia zbuluan trupin e bardhë mami, lëkura i qe mbushur me flluska të zeza. Shërimi i saj zgjati me muaj. Ajo nuk më vinte re. Nuk më njihje.

Që nga ajo kohë rashë në dashuri me vdekjen. E dëshiroja shumë. Natë për natë u lutesha yjeve të më merrnin. Kur po vdisja me të vërtetë, mami sa qe ngritur nga lëngata.

“Çfarë do bëhet me ne, mam, pasi të vdesim?” - e pyeta.

Mama ishte e kthjellët. E qetë. Më kalli një vështrim të gjatë, të dhimbsur, të ëmbël. Vështrimi i mami tim. E njihja dhe besoja njëmend se ishte ajo dritë sysh që më rriste. Foli pa m'i shqitur sytë:

“Kur vdesin vajza të bukura si ti, Sajza, nga dheu mbin një lule e bukur, magjistare, që mban

emrin tënd... “lule-Sajza”, - tha ajo.

“Po unë isha, ma... isha... Tani s'jam më e bukur. Tani jam skelet...”.

Po mami befaz më shpërfilli. Dy minuta më vonë vërtet nuk më njihje më. Megjithatë ia di për nder. Më tha një gjë shumë të bukur. Gjithmonë kam dashur të jem një lule e rrallë, e pangjashme me askënd. Do të vazhdoj prapë të jem si një lule.

Më varrosën. Prisja me padurim stinën e shpërthimit. Por, mu atëherë kur duhej të mbinte lulja nga dheu e hiri im, më zhvarrosën e më varrosën në një vend tjetër. Kjo më mërzi shumë. Duhej prituri një stinë tjetër. Pas nëntë muajsh, se lulet mbijnë në pranverë. Pranvera erdhi, por... s'qe e thënë: sërish më zhvarrosën dhe ma çuan varrin, kësaj here, mu buzë Vjosës.

“Stinën tjetër, patjetër do të çel, - mendova, - e treta, e vërteta!”. Veçse s'u desh të vijë stina tjetër. I fundit erdhi buldozeri. Ai i mori me koritë të gjitha varret dhe i hodhi në lumë.

Kështu, pra, mbeta pa varr.

Sa keq! Në këtë botë të trishtuar qenka thënë që të mos çelë kurrë as edhe një lule-Sajza...



KU PO SHKON, BABË...

- Po a kjo paska kenë vullnesa e Hyjit, moj Djellë?! - iu drejtova gruas teme fatkeqe, fill mbasi shtiva në dhë Marën, të mbramin rob të familjes time jetëprëme.

E vorrova në të djathtë të nanës së tyne. Pa i mbushë 5 pranverat. Tash ajo i ka dy djemtë në të majtë, dy çikat në të djathtë.

Po falesha me robtë e mi ndën dhë, kur erdhën dashamirët.

“Hajde, tash, Nikë! Ka ardhë lirimi! Edhe na, sekushi, ka lanë robtë e vet...”.

Më hoqën me përdhunë.

U përzieva me turmën e lirueme.

Në kâmbë.

“Mbas 7 ditësh”, - thanë, - “me ecë fort, mbërrimë ke shpiat tona”.

Po kur sosëm buzë Vjosës, kambët nuk m'u bindën...

Ndieja zâne mbas shpine. Zâne lutës, qortues, ankestarë. Ato pyesnin në kor, të habitun:

- Ku po shkon, babë...?!

Mandej Djella:

- Ku po na len, Nikë?! Të kujt jena na!?

Rashë në gjunjë. Kruspull. Me sy të ngulun në vrapin e ujnave.

Kjava për herë t'parë... Me zâ. Pa e mshehë ftyrën, derisa perdja e lotëve ma verboi pamjen.

Erdhën dashamirët.
Me më pajtue me vedin.
Më shtypnin shpatullat.
Më fërkonin tamthat.
- Ngrehu, tash, Nikë... Bâhu burrë!
- Po ku me shkue, mor Zot...? Ecni ju... Unë po kthehem mbrapsht... në Komandë...
- E shka me lypë atje, Nikë!?
- Familjen! Të ma gjëjnë... Gjallë, siç e kisha... Gjallë, siç ma morën!



SIKUR BABA...

Sikur baba të ishte vvarë vetëm dy muaj më parë... do të na kishin liruuar... dhe motra ime, Bardha, do të jetonte. Por tim atë e vranë vetëm gjashtë ditë pas vdekjes së Bardhës. Dhe mua më liruuan.

Inatin e kam pasë vetëm me babën.

Babën s'e kam pasë njohur kurrë, ndërsa Bardha e vogël 4 vjeçe, flokverdhë e sykaltër, si një engjëllushe, dha shpirt në prehërin tim.

Po të mos vdiste Bardha, nuk do ta merrja inat tim atë. Por ai la veten ta vrisnin vetëm pasi Bardha kishte vdekur!

Nuk ndreqej më asgjë.

Të paktën të ngutej ta vrisnin më shpejt, para se Bardha të sëmurej.

Do të na lironin dhe motra do të kishte shpëtuar.

A e dinte baba që Bardha lëngonte gjithë atij muaji? Nuk e di...

Di vetëm që, për shkak të tij, na mbanin peng në atë kamp vdekjeje.

Bardha nuk e njihje babën. As unë. Pas vdekjes së mami ajo më kishte vetëm mua: dhe nënë, dhe babë, dhe vëlla.

Isha vetëm nëntë vjeç. Nëntë... në paraditen e asaj dite kur u zvarris gjer te unë dhe më tha me një zë të mekët: “Vlau, bëje prehërin... Tani do vë kokën aty dhe do vdes”.

“Jooo! Ti do flesh!”, - i thashë.

Ajo u mblodh kruspull, zhyti kokën në prehërin tim, ra në gjumë të thellë.

Dhe nuk u zgjua më.



Mbi romanin *Diktatori në Kryq* të Mira Meksit

Kryqi i Diktatorit

nga Shpëtim Doda

Çdo njeri ka Kryqin e vet
Proverb italian

Imësuar tashmë me klimën dhe me botën e krijimtarisë letrare të Mira Meksit, si dhe me *motivët* letrare të veprave të saj, ku spikat fuqishëm Dashuria, – e ngërthyer kjo në të tërë gjerësinë dhe format e saj, nga një besim i epërm romantik tek Erosi, deri te përfytyrimi i tij freudian si maskë dhe instinkt i vdekjes, – lexuesi i saj besnik me siguri do të ndihet i zënë në befasi duke nisur, madje, që nga titulli, *Diktatori në kryq*, i cili, si çdo paratekst, priret t’i ofrojë atij një shenjë në lidhje me traumën rreth së cilës boshtohet rrëfimi – një funksion ky që titulli vërejmë ta mbulojë gjithnjë te romanet e saj.

Në këtë drejtim, duke u nisur që nga titulli i këtij romani, me siguri që do të ndihet i befashuar madje edhe ai lexues që i ka ndjekur në vijimësi zhvillimet dhe prurjet e Letrave Shqipe, ku Mira Meksi gëzon tashmë një status kulturor gjithnjë e në rritje, duke u shpërfaqur pjesë e kanonit të kësaj letërsie dhe duke luajtur një funksion të rëndësishëm përfaqësues brenda saj. Arsyeja është e thjeshtë: në gjykimin tonë, ndryshe nga letërsia e vendeve të tjera, figura e Diktatorit është një *tópos* letrar i pandeshur deri më sot, – më së paku kjo në dijeninë tonë, – jo vetëm në krijimtarinë letrare të Mira Meksit, por edhe në Letrat Shqipe; ajo çfarë ndeshim në letërsinë shqipe, duke u kthyer, për arsye më se të njohura historike, në pjesë e kanonit të saj, ka qenë përjashtimisht vetëm figura e Prijësit apo e Udhëheqësit, ndërkohë që figura e Diktatorit – jo Diktatura! – vijoi të mbetej për shkrimtarët tanë një temë gati-gati tabù edhe pas rënies së Diktaturës.

Kësisoj, qyshse në titullin që mbart, ky roman i hap lexuesit një perspektivë shumë më të gjerë sesa thjesht dhe vetëm një lexim apo një interpretim ngushtësisht dhe përjashtimisht estetik. Vështruar në këtë drejtim, ky roman, i cili shpërfaqet më i ndërlikuar artistikisht dhe më i ngarkuar stilistikisht sesa romanet e tjera të Mira Meksit, shënjon një arritje jo vetëm për krijimtarinë e saj, por edhe për vetë letërsinë shqipe, pasi jo vetëm që pasuron ndjeshëm *tópoi*-t letrarë të kësaj letërsie, por zgjeron dukshëm edhe kanonin e saj, duke sjellë në vëmendje tema dhe figura të patrajtuara më parë, si dhe duke eksploruar në vise letrare të pashkelura deri më sot nga shkrimtarët shqiptarë.

Topoizimi letrar i figurës së Diktatorit

Shekulli XX është pa dyshim një shekull epokal dhe epokalizues njëheri. Është shekulli i triumfit të pandalshëm e të gjithanshëm të pozitivizmit, i revolucioneve dhe i zhvillimeve të hovshme e marramendëse në sferat shoqërore, kulturore, botëkuptimore, etike, politike, ekonomike, teknologjike e shkencore, aq sa Eric Hobsbawm e përkufizon emblematikisht si “shekulli i shkurtër”. Në të njëjtën kohë, shekulli XX është një shekull simptomatikisht tragjik, jashtëzakonisht i mbushur me ngjarje traumatike dhe fatshënjuese për njerëzimin; është shekulli i dy luftërave botërore, shekulli i përplasjeve ideologjike, i

Luftës së Ftohtë, i sistemeve e regjimeve totalitare, i diktaturave dhe mbi të gjitha, shekulli i individualizmit absolut, i perëndizimit të individit, i ngritjes së tij në objekt kulturi; shkurt, është shekulli i lindjes së figurës së Diktatorit, në kuptimin modern të fjalës, i cili konceptualisht është i ndryshëm dhe i dallueshëm nga termi “tiran” apo “despot”, pavarësisht se në përdorimin e përditshëm e ndeshim rëndom si sinonim i tyre.

Përballë një mozaiku të tillë zhvillimesh, topoizimi i figurës së Diktatorit, shndërrimi i saj në *tópos* letrar, mund të na duket diçka sa e natyrshme, po aq dhe e pritshme, pasi një nga misionet që synon vetë letërsia, – dhe që lexuesi pret prej saj! – është pikërisht pasqyrimi i jetës dhe i përvojave të njeriut, i prirjeve, botëkuptimit, botës psikike dhe ndërgjegjes së tij, si dhe i zhvillimeve, botëkuptimit dhe ndërgjegjes historike të shoqërisë në të cilën jeton, të cilat, në një mënyrë apo në tjetrën, projektohen dhe ndikojnë pashmangshëm te jeta, prirjet, botëkuptimi dhe ndërgjegjja e njeriut si i tillë. Megjithatë, pavarësisht kësaj, krahas një lloj intrigimi, si në rastin e Gabriel García Márquez-it, apo edhe një pikënisjeje ideologjike, si në rastin e Ramón del Valle Inclán-it, Robert Graves-it, Christopher Wilson-it, Miguel Ángel Asturias-it, Alejo Carpentier-it, Jorge Zalamea-s, Augusto Roa Bastos-it, George Orwell-it, sa për të sjellë në vëmendje disa shembuj, topoizimi letrar i figurës së Diktatorit lidhet deri diku, më së paku kjo në leximin tonë, edhe me një nga karakteristikat thuajse dalluese të tërë diktatorëve të shekullit XX.

Krahas mizorisë së skajshme dhe ambicieve për pushtet, të tërë diktatorët e shekullit XX i përbashkon edhe ambicia për t’u shpalosur si njerëz të pendës – Lenini shkroi *Zhvillimi i kapitalizmit në Rusi*, Hitleri shkroi *Lufta ime*, Mao Ce Duni shkroi *Libri i kuq*, Josif Broz Tito shkroi disa ligjërata politike, Enver Hoxha *Hrushovianët*, *Titistët*, *Eurokomunizmi është antikomunizëm*, *Shënime mbi Lindjen e Mesme*; Çausheku shkroi disa traktate rreth politikës së brendshme e të jashtme. Sakaq, një pjesë e diktatorëve të shekullit XX ishin pashërueshmërisht të prekur nga “sëmundja e Neronit, iu dhanë edhe ndezullisë së të qenit gjeni të letërsisë; Francisco Franco shkroi romanin *Raza*, Benito Musolini romanin *Dashnorja e Kardinalit*, Omar Gaddaf-i *Libri i gjelbër*, një përmbledhje me tregime të shkurtra, Saddam Hussein-i shkroi katër romane, Oliveira Salazar-i shkroi një *Biografi politike*, Enver Hoxha disa libra me kujtime, si *Vitet e vegjëlisë*, *Baraka e Nushajve*, *Kur lindi Partia*, *Me Stalinin* etj., Fidel Castro *Jetëshkrim në dy zëra*, *Ditarë* etj., Saparmurat Niyazov-i, diktatori i Turkmenistanit, romanin *Libri i shpirtrave*, ndërsa Stalini, Mao Ce Duni, Ho Chi Minh, Kim Jong-il, Gurbanguly Berdymukhamedov-i, diktatori që pasoi Saparmurat Niyazov-in, shkruan poezi.

Pavarësisht nivelit artistik të rëndomtë e mediokër, tërë shkrimet e diktatorëve – realitetet e tyre të ambalazuara me propagandë! – u kthyen programatikisht në pjesë thelbësore e kultit të personalitetit të tyre, u përkthyen, me urdhër të tyre, në shumë gjuhë të huaja dhe u shpërndanë në mbarë globin si një mesazh i denjë për tërë popujt, madje u veshën me breroren e teksteve të shenjta, u shndërruan në “bibël”, për t’iu imponuar me detyrim, si mjet

edukimi dhe busull orientimi tërë popullit, përfshirë – madje në mënyrë të veçantë – edhe atë pjesë të tij e cila ishte armike e regjimit; në këtë drejtim, teksti më “edukues” mbetet pa dyshim “kryevepra” e diktatorit Berdymukhamedov mbi “artin e pirjes së çajit”, mbi “dobitë mjekësore dhe ndikimin e tij në të menduarit, në filozofinë, kulturën dhe botëkuptimin e njeriut”.

Dhe jo vetëm kaq, mes diktatorëve të shekullit XX pati syresh që shkuan akoma më larg, guxuan të jepnin formula, direktiva e receta për letërsinë dhe artin, duke imponuar në jo pak raste “modele”, për t’u shfaqur në formën e një “bible të artit”. Kështu, Lenini shkroi *Organizata e partisë dhe letërsia e partisë*, Stalini *Mbi artin dhe kulturën* dhe një pamflet mbi gjuhën, Mussolini mbajti një sërë fjalimesh mbi artin fashist, Mao Ce Duni shkroi *Mbi letërsinë dhe artin*, Enver Hoxha shkroi, po ashtu, *Mbi letërsinë dhe artin*, Fidel Castro shkroi *Dialogu i qytetërimeve*, si dhe mbajti një sërë fjalimesh mbi letërsinë dhe artin revolucionar, Kim Jong-il shkroi një libër *Mbi artin e kinemasë* – një studim tejet i “thellë” dhe “brilant” ky, i cili vatërsohet në gjetjen, në zbulimin, apo në idenë “gjeniale” se “në një film, pamjet duhet të duken qartë dhe mirë në ekran”.

Kësisoj, përmes “kryeveprave” të tyre, të gjithë diktatorët e shekullit XX përvijuan dhe formësuan, kush më shumë e kush më pak, jo thjesht një “bibliotekë”, por edhe një kanon të mirëfilltë, atë diktatorial, duke përfshirë në të edhe letërsinë dhe artin; mjaft të mbajmë parasysh ngjashmëritë e skajshme që vërehen lehtë mes veprave të tyre.

Përpjekja për të përvijuar dhe për të formësuar një kanon të këtillë lidhet jo vetëm me vetëdijen e diktatorëve për fuqinë e artit si mjet efikas propagande dhe manipulimi, por, në mënyrë të veçantë, me frikën që ndienin nga Pushteti i artit, ndikimin e të cilit e patën ndier së pari vetë, në psikën e tyre; kështu, për shembull, romani *Ç’të bëjmë?* i Nikolaj Çemishhevskijt la një ndikim aq të thellë te Lenini, sa që tërë jetën e tij ky u përpoq që të imitonte me fanatizëm Rahmetovin, njërin prej personazheve të romanit. E njëjta gjë pati ndodhur me Stalinin; romani *Atëvrasja* i Aleksandër Kazbegit pati një ndikim aq të thellë tek ai, sa që emrin e personazhit kryesor, Koba-s, e përdori si pseudonim për veten. Për rrjedhojë, krahas shfrytëzimit të artit si një mjet propagande e manipulimi, përvijimi dhe formësimi i kanonit diktatorial lidhet me synimin e diktatorëve për të përvetësuar edhe Pushtetin e artit, me qëllim që të neutralizonin frikën që ndienin ndaj tij.

Duke mbajtur parasysh një kuadër të këtillë, topoizimi letrar i figurës së Diktatorit nuk lipset vështruar kurrësi si idolatri, apo si përpjekje për të lartësuar ose për të përjetësuar dhe për të përligjur një figurë të tillë; përkundrazi, krahas shumëçkaje, topoizimi letrar i figurës së Diktatorit, letrarizimi i saj, është deri diku edhe një formë për t’i kthyer Cezarit çfarë i takon Cezarit dhe shkrimtarit atë çfarë i takon shkrimtarit; shkurt, pra, është një përplasje mes dy kanoneve, kanonit të letërsisë dhe atij të diktaturës, çka vërehet qartësisht te një nga karakteristikat përbashkuese të topoizimit letrar të figurës së Diktatorit; shprehimisht, paraqitja tipizuese apo arketipizuese e kësaj figure. Në shkrimet e tyre për letërsinë dhe artin, tërë diktatorët e shekullit XX mëtojnë të përvijojnë dhe të formësojnë sipas nevojave dhe qëllimeve të tyre një “model” ideal, tipik dhe arketipik, të shkrimtarit dhe artistit, për t’ua imponuar më pas këtë “model” të tërë shkrimtarëve dhe artistëve. Nga ana tjetër, në topoizimin e tyre letrar dhe artistik të figurës së Diktatorit, edhe shkrimtarët dhe artistët mëtojnë të përvijojnë dhe të na paraqesin figurën tipike e arketipike të Diktatorit, duke ua kthyer kësij diktatorëve me të njëjtën monedhë, si të thuash, dhe kjo vërehet qartë edhe në ato raste kur shkrimtari pikëniset nga një shembull i veçantë. Shembujt më të qartë të kësaj karakteristike që i brendashkruhet topoizimit letrar të figurës së Diktatorit i ndeshim te Miguel Asturias, Carpentier-i, Orwell-i, García Márquez-i, Wilson-i etj., tek të cilët kuptohet qartë se topoizimi letrar i figurës së Diktatorit është edhe një kundërpërgjigje, një pozicionim i ndërgjegjes krijuese dhe mbi të gjitha, formë qëndrese e letërsisë përballë diktatit, diktaturës dhe diktatorëve.

Topoizimi i figurës së Diktatorit te Diktatori në Kryq

Në topoizimin letrar të figurës së Diktatorit te *Diktatori në Kryq* i Mira Meksit ndeshim thujse të tëra elementet e tablosë së paraqitur në sythin pararendës, të përcjella përmes satirës, humorit, ironisë së hollë, sarkazmit, madje edhe parodisë, dhe, mbi të gjitha, përmes epifanive dhe fantazisë rrëmbyese.

Së pari, pavarësisht se pikëniset nga një shembull i veçantë, nga një personazh historik (lexuesi e rrok lehtë se për kë është fjala), në topoizimin letrar të figurës së Diktatorit Mira Meksi mëton, dhe ia arrin, të përvijojë dhe të paraqesë arketipin e Diktatorit, ndonëse fjala është për një arketip lokal, për arketipin e Diktatorit të Luftës së Ftohtë, i cili te Stalini pati gjetur mishërimin dhe shprehjen e vet më të qartë dhe më emblematike. Episodi i “pagëzimit të Stalinit”, si dhe interpretimi që i bën vetë Diktatori përgjatë përsiatjeve dhe përpjekjeve të tij për të zbrërthyer kumtet e ëndrrave që i ishin fanepsur, shfaqet mjaft domethënës në këtë drejtim. Sakaq, në këtë roman ndeshim, jo rastësisht, edhe djegien e teksteve të shenjta dhe zëvendësimin e tyre me “biblën” e Diktatorit, çka jo rastësisht zë vend mbas këshillimit të tij me Stalinin. Ëndrrat e Diktatorit me episodet kulmore të Dhiatës së Vjetër dhe Dhiatës së Re, në të cilat është vetë protagonist, e përcjellin mjaft ndjeshëm dhe në mënyrë efikase një pamësi të këtillë. Po ashtu, në këtë roman ndeshim më tepër se një herë përkthimin dhe botimin e veprave të Diktatorit në shumë gjuhë, për t’u shpërndarë më pas nëpër botë nga ambasadat shqiptare. Sakaq, njësoj si te romanet e tjera, edhe te ky roman vërejmë se si ndërgjegjja krijuese i kapërcen kufijtë e ngushtë të vetjakes dhe shkrihet njëshmërisht me imagjinatën krijuese, përmes së cilës Mira Meksi e zeron paq largësinë mes saj dhe Diktatorit; që në faqet e para arrin të depërtojë jo vetëm në vetminë e dhomës së tij, por edhe në mendjen, në ndërgjegjen, në psikën, madje dhe në pandërgjegjen dhe pavetëdijen e Diktatorit, për të rrokur psikozën, parandjenjat, ndjesitë, ankthet, përjetimet, frigimet, dyshimet, paranojat, brerjet e ndërgjegjes, këndvështrimet, mendimet, bindjet dhe idetë e tij, ndërmjet të cilave, jo rastësisht, ndeshim të paraqitur edhe vetëdijen që Diktatori ka në lidhje me Pushtetin e artit, çka Meksi e jep në mënyrë tejet efikase përmes mendimeve dhe përjetimeve të tij teksa mban vesh *La vie en rose*, apo teksa sjell ndër mend *Zogjtë* e Hitchcock-ut, apo dashurinë e jetuar dhe përjetuar gjatë rinisë së tij përmes “thjerrës” së Balzak-ut dhe tablove të Gauguin-it etj., pa anashkaluar assesi ndërkaq episodin e farsës së sprovës së Kryqit, gjatë së cilës Diktatori kërkon që të imitojë Krishtin ndërsa e urdhëron “kavjen” të dalë nga qefini dhe të ngrihet në këmbë; madje, në këtë roman ndeshim, jo rastësisht, edhe vlerësimin që Diktatori i bën vetes si shkrimtar: “Për një piramidë të vetën i qau zemra ato çaste. Një piramidë që nuk do të ishte varr për të, larg qoftë, ku ai do të shkëlqente me mungesën e tij. Një piramidë që do të mbante kujtimet e tij për t’ia shpalosur njerëzimit, në jetë të jetëve. ‘Aty do t’i keni të gjitha, pa fshehje, pa ambalazhime, puro. *Aty dhe në titujt e librave të mi do të gjeni kumtet e mia*’, iu drejtua me mendje të gjithëve. *‘Veç të keni tru për t’i lexuar dhe deshifruar’*, tha, jo pa ironi.” (Pjerrëzimi shkronjor yni – Sh. D.)

Ndërkaq, topoizimi letrar i figurës së Diktatorit, krahas të qenit deri diku një formë për t’i kthyer Cezarit çfarë i takon Cezarit dhe shkrimtarit çfarë i takon shkrimtarit, është edhe një formë e çmitizimit dhe e demistifikimit të figurës së Diktatorit, e zhveshjes së saj nga shkëlqimi dhe brerorja mbinjerëzore, heroike,

e lavdishme dhe e pavdekshme, me të cilat e patën mbështjellë qoftë ai veten, qoftë propaganda e orkestruar prej tij. Te ky roman çmitizimi dhe demistifikimi i figurës së Diktatorit realizohet përmes kontrastit të fortë mes perceptimit të jashtëm rreth Diktatorit dhe perceptimit që vetë Diktatori ka për veten. Që në faqet e para romani na vendos përballë Diktatorin, një njeri jo i plotfuqishëm, por i pafuqishëm; një njeri që tashmë ka ndjesinë se po jeton “një ekzistencë fantazmë” brenda një “bote të zymtë”; një njeri që tronditet ndërsa zbulon befaz vetminë që i ka gllabëruar çdo hapësirë, jo vetëm dhomën, por edhe shtratin, jo vetëm shtëpinë, por edhe hapësirën jashtë saj, thujse i braktisur, pa ndjekës, pa njerëz të cilëve mund t’u besonte; një njeri që e kupton qartazi se pushteti i ka rrëshqitur nga duart dhe ndihet krejt i pafuqishëm për të reaguar përballë njerëzve që e rrethojnë, që “i fshihnin të vërteta, sajnin realitete të rreme, krijonin një udhëheqje shteti mediokre nën hundën e tij, kur merrnin vendime në këmbë të tij me

se “ka ardhur koha” të përballet me vdekjen. Sythi i parë i kapitullit I, i cili na paraqet paraprakisht traumën e romanit, vatrësohet te frazat “parandjeu fundin” dhe “kish ardhur koha”, të cilat janë jo vetëm pikëlidhja e dy pjesëve të këtij sythi, por edhe *istos*, boshti i romanit si një i tërë. E megjithatë, pavarësisht kësaj, përmbajtja dhe shtrirja e rrëfimit në faqet e këtij romani zhvillohen përtej këtij konstatimi, duke e shndërruar këtë në kuadër epifanik, zbulestar, brenda të cilit shfaqen dhe rrëfihen edhe ngjarjet më thelbësore të jetës së Diktatorit, shpeshherë të përcjella përmes kujtimeve, përsiatjeve apo monologëve që ky zhvillon me vetveten.

Vetëdija se tashmë kish mbërritur ora e mbrame e shtyn Diktatorin të përsiatet në vetminë e dhomës së tij rreth vdekjes dhe pasvdekjes. Ndryshe nga sa mund të pritej, përballja me një gjasë të këtillë nuk mbart kurrfarë dramaticiteti; përkundrazi, Diktatori “u mundua t’i mbushte mendjen vetes se fundi ishte në rrjedhën e vet të natyrshme”. Dhe jo vetëm kaq; në përsiatjet e

Diktatorit rreth vdekjes dhe pasvdekjes së sivëllezërve të tij lexuesi ndeshet me një sarkazëm e humor çmitizues dhe demistifikues njëherazi. Është e vërtetë, sakaq, se në një moment Diktatori ndien frikë, “frikën e takimit, në atë rrugëtim të mbramë, me viktimat e tij”, sidomos kjo me njerëzit e tij të afërt dhe me “shokët armiq”, të vetmit që i krijonin shqetësim; është e vërtetë se edhe ofshan për numrin e tyre të madh, porse kjo frikë nuk krijon kurrfarë brejtjeje të ndërgjegjes, kurrfarë rimorsi zhgurues. Përkundrazi, davaritet shumë shpejt dhe ftohtazi, përmes përligjjes në emër të ideologjisë, të projektit të ndërtimit të rendit të ri dhe njeriut të ri, viktimat e panjohura (çdo revolucion ka nevojë të domosdoshme për viktimat e veta!), si dhe të mbijetesës, viktimat e njohura, njerëzit e afërt dhe shokët armiq – “Më mirë të marrësh se të japësh: të marrësh vdekje se të japësh vdekje”. Dhe jo vetëm kaq; fill pas përligjjes në lidhje me viktimat dhe gjakun e derdhur, si për të nënshkruar një traktat paqeje me ndërgjegjen e tij, Diktatori premton vetë me vete: “në rikthim shumëçka duhet të ndryshojë” dhe kridhet “me shpejtësi në ringjalljen e tij të fshehtë dhe të sigurt, si në një intimitet të ngrohtë dhe të dashur, por edhe të mistershëm njëkohësisht”, prej nga lexuesi kupton qartë qetësinë me të cilën Diktatori përsiatet rreth vdekjes dhe pasvdekjes së tij. Përmes kësaj kthese të beftë, rrëfimi në këtë pikë na zbulon poetikën e tij të ndërlikuar; fjala është, më konkretisht, për strukturimin e tij dhe spiralor, i mbështetur mbi një sistem “hapjesh” progresive, që këtu do të thotë shprehimisht se çdo kapitull zhvillohet duke ndjekur një “hapje” përkatëse, e cila, nga ana e saj, projektohet si e tillë qysh në kapitullin pararendës. Kështu, pas projektimit të gjasës së ringjalljes në kapitullin e parë, në kapitullin vijues

rrëfimi vatrësohet te zbrërthimi i “misterit”, te Kryqi i cili përbën edhe pjesën e dytë të titullit të romanit. I vështruar në këtë drejtim, ndërkaq, si pjesë e paratekstist, termat “diktator” dhe “kryq” të titullit hedhin dritë mbi dy histori, të cilat zhvillohen paralelisht, aq sa mund të thuhet se kemi të bëjmë me një roman brenda romanit, dhe që në fund pikëpritën, bashkohen dhe shkrihen në traumën e romanit si një i tërë.

Diktatori ishte më se i vetëdijshëm se lufta për pushtet, lufta për pasardhësin e tij kish nisur tashmë dhe po zhvillohej nëndheshëm dhe me shpejtësi; ajo çfarë Diktatori nuk dinte, ishte gjasja se viktimat e kësaj lufte të egër të Pushtetit do të ishte ai vetë, se Pushteti do të ishte jo thjesht dhe vetëm streha dhe ngrehina e vetmisë së tij, por edhe vetë Kryqi mbi të cilin do ta kryqëzonin për së gjalli dhe për së vdekuri. Në fund të fundit, siç është fatshkruar të ndodhë në fund të “biblës” së çdo diktatori.

(Pjesë nga *pasthënia e librit*)



anë informacionesh të rreme, kur i hidhnin dorën në qafë, ndërkohë që tinëzisht punonin kundër tij e Partisë së tij, kur shpiknin përbetime e grupe armiqësore në emër të tij, ndërkohë që në të vërtetë ishin ata vetë që po i shfarosnin njerëzit e tij besnikë një nga një, kinse me dorën e tij”; një njeri i brerë nga ankthe, pasiguri dhe dyshime se edhe njerëzit e familjes po i minonin jetën; një njeri që gjallon brenda një paranoje, “me frikën e një psikozë”, me “tmerrin se në kraharor mbante një bombë me sahat, e cila mund të shpërthente nga çasti në çast”; një njeri që ndihet më tepër i vdekur se i gjallë, si i varrosur për së gjalli, ku folja “përgjoj” te fraza që Diktatori mendon me psherëtimë, “në këtë shtëpi përgjohen edhe dëshirat e pathëna”, mbart edhe kuptimin e “përgjimit të të vdekurit”; shkurt, pra, një njeri që, teksa vigjilon rrahjet e çrregullta e të frikshme të zemrës dhe sinjalet e oksidimit përfundimtar të gjakut, mushkërive dhe mëlçisë, “parandien fundin” e tij, kupton

Përse shtëpia e famshme botuese “Faber & Faber”, refuzoi të botojë “Uliksi-n” e James Joyce-it, “Fermën e kafshëve” të George Orwell-it, dhe vepra të tjera si këto...

Letrat më famëkeqe të refuzimit për botimin e librave

Toby Faber

Historia e botimit është e mbushur me rrëfenjat e autorëve që provuan refuzim pas refuzimi, shpesh për vite me radhë, para se të arrinin të gjenin më në fund një botues të gatshëm për t'i botuar. Historitë e tyre zakonisht kujtohen për të nxitur çdo shkrimtar që përballet me sproven e botimit për të përcjellur mesazhin se “duhet këmbëngulje, dhe herët a vonë do t'ia dilni”. Në të njëjtën kohë, natyrisht, ato mund të interpretohen si rrëfenja që ftojnë botuesit të tregojnë kujdes pasi duket sikur duan të thonë: “Ja pra, e shihni çfarë gabimesh të pafalshme keni bërë” si dhe: “Nxirrni mësim nga këto gabime.”

Nuk mund të them se jam dakord me pjesën e parë të këtij qortimi. Puna kryesore e një botuesi është të tregojë shije në përzgjedhjen e asaj që do të botojë. Nuk mund të presin që gjithmonë të qëllohet në shenjë, dhe ndoshta më mirë të gabosh në përzgjedhje se sa të botosh libra pa vlerë. Ideja se ne botuesit duhet të mësojmë nga gabimet tona, sidoqoftë, ose të paktën t'i pranojmë ato është shumë më bindëse. Më së paku, pengon krenarinë e tepërt e të zakonshme në raste të tilla. Ka shumë pjesë të historisë së Faber-it që më bëjnë krenar, por nuk humbasim asgjë nëse kujtojmë edhe ato histori ku janë bërë nganjëherë gafa.

T.S. Eliot refuzon botimin e W. H. Auden-it

T. S. Eliot i shkruan W. H. Auden-it, 9 shtator 1927:

Më duhet t'ju kërkoj ndjesë që ua mbajta poezitë për kaq shumë kohë, por mua më duhet vërtet

shumë kohë për ta ndarë mendjen. Nuk kam ndjesinë se ndonjë nga poezitë e dërguara është krejtësisht në rregull, por më kanë ngjallur interesin që ta ndjek ecurinë e veprës tuaj. Kam frikë se jam shumë tepër i zënë për ta pasur të mundur një shqyrtim të hollësishëm kritik për secilën poezi, çfarë do të ishte e drejtë, por ju ftoj që kurdo që të ndodheni në Londër mund të më vini në dijeni nëse dëshironi dhe do të ishte kënaqësia ime nëse do të vinit të më takonit.

Auden-i nuk u shkurajua nga kjo përgjigje, pasi i shkruan Christopher Isherwood-i, “Po ta shohësh hollë, Eliot-i më rezervoi një takim dhe mendoj se kjo është goxha arritje.” Për më tepër, mospranimi ishte thjesht i përkohshëm. “Faber” botoi në 1930 një volum të Auden-it me titullin e thjeshtë “Poezi”, tregues se ishte në kërkim të një standarti të ri në poezi. Kur Auden vdiq në 1973, “Faber” kishte botuar afërsisht 20 përmbledhje me poezi me emrin e tij.

T. S. Eliot refuzon James Joyce-in

T. S. Eliot i shkruan James Joyce-it, 20 prill 1932:

Kemi diskutuar çështjen e botimit të romanit “Uliksi” në Angli në mënyrën më shteruese të mundshme, dhe kemi shqyrtuar të gjitha mendimet e ndryshme për këtë mundësi në të ardhmen. [. . .]

Jemi këshilluar se me siguri do të përballemi me padi penale dhe dënim të rëndë, me shumë

mundësi dënimit e drejtorit me gjashtë muaj burg, gjë që do ta rrëronte biznesin e botimeve. Mendimi mbizotërues është se një padi e tillë penale do të ndodhte pa asnjë dyshim.



Është e vështirë ta besosh tani se deri në çfarë mase kufizoheshin botuesit nga censura deri në vitet 1960-të. E paralizuar nga frika e padisë penale për imoralitet, Faber i mbetej vetëm të shihte si do rridhnin ngjarjet ndërsa shtëpia botuese “The Bodley Head” u bë botuesi anglez i “Uliksit” më 1934. “Faber” kishte nisur të botonte fragmente të veprës së Joyce-it me titullin “Vepër në proces” e cila më pas u botua e plotë në vitin 1939 me titullin “Zgjidhja e Fineganëve”.



T. S. Eliot refuzon George Orwell: “Përmes dhe përtej Parisit dhe Londrës”

T. S. Eliot i shkruante Eric Blair-it (George Orwell), më 19 shkurt 1932:

Më vjen keq që ju ua kam mbajtur dorëshkrimin. Për ne ishte me shumë interes, por më me keqardhje më duhet të them se nuk duket të jetë i mundur botimi i tij. Libri është pa dyshim tepër i shkurtër, dhe veçanërisht për një libër të tillë mua më duket se pjesët janë të bashkuara pa lidhje të drejtpërdrejtë pasi episodet franceze dhe angleze përbëjnë dy pjesë që pak lidhen me njëra-tjetrën.

T. S. Eliot hodhi poshtë botimin e “Përmes dhe përtej Parisit” (Victor Gollancz e botoi më 1933) dhe kështu e humbi mundësinë të botonte





George Orwell-in në fillim të karrierës së tij. Atij iu dha një mundësi tjetër.

T. S. Eliot refuzon përsëri George Orwell-in: "Ferma e kafshëve"

T. S. Eliot i shkruan George Orwell-it, 13 korrik 1944:

E di se doni të kishit sa më shpejt vendimin për "Ferma e kafshëve" por më e pakta që kërkohet është mendimi i dy drejtorëve, dhe kjo nuk mund të bëhet brenda një jave. Por meqë është e rëndësishme shpejtësia, duhet ta kisha pyetur edhe drejtorin tjetër që ta lexojë. Por njëri nga drejtorët është dakord me mua në pikat kryesore. Ne pajtohemi që është letërsi me vlera mëse të dallueshme; fabula zotërohet mjeshtërisht, në aspektin e rrëfimit ai ta mban gjallë kërkshërinë vazhdimisht dhe është një cilësi që pak autorë e kanë arritur që prej Guliverit.

Nga ana tjetër, ne nuk jemi të bindur (dhe jam i sigurt se asnjëri prej drejtorëve nuk do të jetë i bindur gjithashtu) se ky është këndvështrimi i duhur për ta kritikuar situatën politike në kohën e sotme [...]

Më vjen shumë keq, sepse kushdo që e boton

këtë libër, do të ketë natyrshëm mundësinë e botimit të veprës tuaj të ardhshme dhe unë kam konsideratë për veprën tuaj, sepse është letërsi e mirë me integritet të palëkundur.

Është paragrafi i fundit që më bën përshtypje më shumë: duke e hedhur poshtë "Fermën e Kafshëve" në thelb sepse tregohej e ashpër ndaj aleatëve tanë sovjetik, Elioti po hidhte poshtë gjithashtu edhe veprën e pashkruar "1984".

Faber POTHUAJSE refuzoi "Perëndia e mizave" të William Golding

William Golding to Faber & Faber, 14 September 1953:

Po ju dërgoj dorëshkrimin e daktilogafuar të romanit "Strangers From Within" i cili mund të përkufizohet si interpretim alegorik i një situatë arketipale. Shpresoj që do të jeni në gjendje ta botoni.

Komentet e atyre që e kanë lexuar dorëshkrimin e pakërkuar voluminoz janë shkruar me dorë në këndin e sipërm të majtë të letrës që duhej të ishte porosia për kthimin e përgjigjes:

"Koha, e ardhmja. Fantazi absurde dhe jointerese për shpërthimin e një bombe atomike


në koloni. Një grup fëmijësh që zbarkojnë në një vend xhungle pranë Guinesë së Re. Pa vlerë dhe e mërzitshme. Kot fare. Të refuzohet."

Redaktori Charles Monteith i cili kishte vetëm një javë që punonte me botuesin, vijoi leximin e kreut të parë të dorëshkrimit "pa vlerë dhe të mërzitshëm", për të gjetur diçka shumë më interesante. Faber e rititulloi romanin "Perëndia e mizave" dhe e botoi në vitin 1953. Botimi i Faber shitet mbi 100.000 kopje çdo vit.

Faber refuzon Paddington Bear, Michael Bond

Raport për librin "Ariu me emrin Pedington" me autor Michael Bond, 28 gusht 1957:

Mendoj se autori e ka humbur fillin në këtë histori për një ari të birësuar nga familja Braun, e cila i përket klasës së mesme. Ndoshta gjykoj unë gabim por ai ka si qëllim që të jetë argëtues ndërkohë që shakatë të gjitha lidhen vetëm me ariun; Braunët e trajtojnë, siç e përfytyroj, unë ashtu si trajtohet një "i huaj" dhe teksa ndjenjat e pëlqimit dhe dhembshurisë ngjallen vetëm për ariun, është e vështirë që autori të të bëjë të qeshësh. Për më tepër famija Braun janë teveqel të përsosur, e lënë ariun vetëm në vaskë dhe ai gati mbytet se nuk





orientohet dot me stilin modern të jetës; dy herë të tjera u humb, një herë në metro dhe një herë në një qendër tregtare thjesht se nuk tregohen të vëmendshëm prindërit Braun. Jo, singerisht, gjëja më e mirë e këtij libri është titulli.

Është prapavështrimi (retrospeksioni) ai që e bën argëtues sigurinë e gjykimit përfundimtar. Si pjesëtar i Faber, thjesht mund të ndjej keqardhje, por si lexues, jam i kënaqur që një botues tjetër e kuptoi se libri kishte vlera. Pavarësisht nga gabimet, redaktorët e Faber kanë marrë shumë vendime të mira gjatë historisë duke krijuar një autoritet të jashtëzakonshëm letrar në fushën e botimit të letërsisë artistike. Deri më sot, shkrimtarët e botuar nga Faber kanë fituar trembëdhjetë çmime Nobel, shtatë Booker Prize dhe njëmbëdhjetë çmime Pulitzer për poezinë. Natyrisht jam krenar për këtë histori arritjesh, dhe jam po ashtu krenar që Faber ia ka dalë të ketë këtë sukses duke ruajtur pavarësinë e saj për 90 vjet.

Përktheu: Granit Zela

Botim i "LitHub", shkëputur nga libri "Faber & Faber: The Untold Story by Toby Faber".



NJË VJETORI I GAZETËS

ExLibris

e përjavshme letrare & kulturore

